

Akoma nuk keni një website?

Akoma nuk jeni regjistruar në Google

Për çdo konsultim mund te vini në çdo kohë në zyrat tona

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road, London, E13 8HT
Tel:020 7018 7929 Mob: 073 4066 5946 Mob:078 5997 7545




The **Albanian**

VITI I 20 I BOTIMIT 25 MAJ 2024

Tel: 020 7018 7929 30 Avenons Road London E13 8HT

A DO TË TAKOHET RAMA ME ÇUNAT E LAMANSHIT?



PETRIT KUÇANA
PSE-JA E TAKIMEVE
TË RAMËS ME
SHQIPTARËT
E DIASPORËS



ARBEN MANAJ
Urdhri i Perandorisë
Britanike i jepet
shqiptarit për
kontributin mes
dy vendeve

INTERESI BRITANIK
PËR BALLKANIN
DHE SHQIPTARËT

DAUT DAUTI




"SHQIPËRITË"
TONA KALBEN
NGA BRENDA!

KIM MEHMETI



FAJTORËT
E QORRSOKAKUT

ENVER ROBELLI



A FLASIN BANDAT
PËR POLITIKË
NË PËRGJIME?

LUTFI DERVISHI



SERBIA MES
TITOS DHE
ENVER HOXHËS?

VETON SURROI



POROSISNI BANNERIN PËR BIZNESIN TUAJ

- Business Cards
- Logo
- Flyers
- Video Marketing

Na kontaktoni: **020 7018 7929**

Dotech
website




The Albanian newspaper in London


THE ALBANIAN
www.thealbanian.co.uk

www.thealbanian.co.uk

albania7@gmail.com

Tel: 020 7018 7929

**PETRIT KUÇANA**

Pse-ja mbetet akoma kokëfortë për shumë mendja racionale, që nga njoftimi për turin e Ramës nëpër shqiptarët e Diaporës. Londra, si stacioni i tretë i udhëtimit thuajse amorf, duket se doli jashtë parashikimeve dhe u shty në kohë, ndonëse për çdo mendje racionale vazhdon të mbetet 'pse'-ja e kohës, pse tani dhe e mënyrës- pse kshtu? Sa kushtoi takimi i Athinës?

A DO TË TAKOHET RAMA ME 'ÇUNAT E LAMANSHIT'?

As gëk as mëk nuk u dëgjua, e madje as kolegët e medias nuk i mëshojnë kësaj pyetje kaq normale për çdo demokraci funksionale. Në vendin më të varfër të Evropës? Mbase do të ngjante tepër cinike nëse thuhet se nëse Rama do të ishte kryeministër danez do të regjistronte një fjalim bie fjala për shqiptarët e Britanisë dhe do ta përhapte nëpër rrjetet sociale, medja etj dhe ja ku u përçua mesazhi i tij. Nëpër ngjyrat e folklorimit ngjeshur me fjalime të ndjeshme udhëtimesh, Rama tenton të fshijë çdo përgjegjësi si kryeministri i mandatit të tretë, për të dalë në bregun e krenarisë së boshtë...

Në Londër Rama ka ardhur të paktën 20 herë dhe as edhe njëherë të vetme nuk ndaloi për të zhvilluar një takim me shqiptarët e këtushëm. Po takohet ne vitin e fundit të mandatit të tij, kur asnjë statistikë nuk

dihet akoma se sa është numri i shqiptarëve të larguar gjatë mandatit të tij. Sa shkolla janë mbyllur? Britania ka një specifikë tjetër, kur vetëm pak kohë më parë La Manshi u shndërrua në Otranton e dikurshme, kur shqiptarët ishin të parët në shifrat e të ardhurave, shqiptarët e Natos, shqiptarët e vendit evropian, ballkanikët e vetëm, duke çuditur opinionin britanik dhe më gjerë. Pse-ja nuk u gjend kurrë edhe kur mijëra e mijëra shqiptarë mësynë La Manshin me gomonet e shpresës, duke braktisur parajsën propagandistike të vendit të vogël, të udhëheqësit të madh. Eklips i paharueshëm për shqiptarët e këtushëm. Sërish kthehet tek shifrat ajo mendja racionale kur mendon se të paktën dy shqiptarë u vranë, u vetvënë vetëm për të mos u kthyer në parajsën propagandistike të Ramës. Tragjedia e tyre nuk e pati

mortjen si aktin e fundit. Arkmortet u lanë rrugëve nga shteti i begati i udhehequr nga Rama pasi u thanë familjarëve që shteti nuk ka lekë (përdhuhet neni 8 i kushtetutës) dhe u mblodhën ndihma nga bashkëatdhetarët për të dërguar ark-mortet në mëmëdhe. Sa kushtoi takimi i Athinës? Po arkmortet e shqiptarëve të vetëvranë në Britani? Sa kushtoi takimi i Milanos? Patjetër që çdo punonjës i administratës shtetërore do të pyeste për kostot e këtyre takimeve ndërkohë që pagat e tyre garantojnë vetëm mjerim, e sidomos të atyre punëtorëve të sektorit diplomatik nëpër shtete të ndryshme që janë për turp e faqe të zezë. Një diplomat shqiptar në Londër (dhe jo vetëm) duhet ta kalojë ditën me pak paund dhe askush nuk e vret mendjen për të, pasi konsiderohen si favor që iu është bërë...

Do të ishte mëse i mirëpritur çdo takim i Ramës me diasporën. Imagjinoni nëse Rama do të takonte dhe të dëgjonte çunat e La Manshit. Të dëgjonte përfaqësues të shqiptarëve ekselentë në Britani, të PHD-ve, doktorve të shkencave, akademikëve shqiptarë të këtushëm. Do të ishte tejet e domosdoshme një takim i kryeministrit me biznesmenët e këtushëm shqiptar, që kanë arritur suksese të jashtëzakonshme në metropolin britanik por që kurrë nuk u konsideruan as si investitorë strategjikë në mëmëdhe, as si partnerë të kompanive që fitojnë tenderat e shumëzurmshëm e shumëzollumshëm. Atëherë do të konsiderohej takim dhe asnjë pikë vlere nuk do të kishte folklori, sidomos kur diaspora shqiptare të vronte si të gjithë vendet e tjera. Atëherë Rama do të kujdesej me patjetër që të takonte edhe çunat e La Manshit dhe me patjetër do të tregonte se sa kishin kushtuar takimet e Athinës, apo Milanos...



AVOKATET E EMIGRACIONIT PËR SHQIPTARËT NË UK

HA Haris Ali Solicitors

If you are a child born in the UK with no immigration status, after 7 years in the UK you can apply straightaway for indefinite leave to remain (ILR).

Call: 0208 8570 7300 | Mobile: 07967 467414 | www.harisalisolicitors.co.uk

19 Kingsley Road, Hounslow, London. TW3 1PA

IMPERIUM CHAMBERS

(ZYRE LIGJORE ME BARISTER TE KUALIFIKUAR PREJ 25-VITESH)

A JENI KONFUZ NGA
NDRYSHIMET E SHUMTA
LIGJORE TE EMIGRACIONIT DHE
KENI NEVOJE PER NDIHME DHE
QARTESI?!

-NUK JENI
VETEMI!

Tel 1: 07901181592

Tel 2: 02072423488

Address: Thanet House, 231-232
Strand, Temple, London,
WC2R 1DA

NE JEMI TE SPECIALIZUAR NE CDO FUSHE TE EMIGRACIONIT

DHE OFROJME NDIHME ME GJITHCKA PERFSHIRE:

Refuzimin e azilit pa te drejte gjyqi
Aplikime/ri-aplikime nga e para
Apelime ne te gjitha gjykatat
Bashkime familjare ose visite ne uk



TELEFONONI **ADELEN** NE **07901181592** PER T'U KONSULTUAR



Keni nje Bizness qe po rritet?

**DONI TE MERNI PUNETOR NGA SHQIPERIA NE
ANGLI?**

TE SPECIALIZUAR NE

BUSSINESS IMMIGRATION OFROJME APLIKIM TE SIGURTE PER **SPONSORSHIP LICENSE**

Bizneset perfshijne:


Kompani ndertimi
Restorante/café
Car washes

Care homes
Office work
Berber

***DHE SHUME BIZNESE TE TJERA**

SHERBIMET QE OFROJME:

- Human Rights
- Judicial Review
- Appeals
- Fresh Claims
- Asylum
- Overstayers
- Stateless
- Detention and Bail
- EEA Family Permit
- ILR/Natyratisation
- Change of Nationality from Kosovan to Albanian
- Work and Student Visa
- Spouse Visa
- Visitor Visa
- Divorce



Email:
adela.bushi@imperiumchambers.co.uk
enquiries@imperiumchambers.co.uk
Website:
www.imperiumchambers.co.uk
YouTube:
The Immigration Barrister



ARBEN MANAJ

Pranimi i Rishi Sunak se nuk do ketë fluturime drejt Rundës përpara datës se zgjedhjeve të reja të 4 korrikut, por vetëm pas kësaj date, nëse partia e tij fiton, si dhe hedhja në kosh e kësaj politike nga opozita, nëse fiton zgjedhjet, siç mund të ndodhë, sipas njohësve të politikës dhe sondazheve me diferencë mjaft të thellë, nuk përbën lajm të mirë për luftën kundër emigrimit ilegal.

Përkundrazi, ekziston frika dhe shqetësimi publik, se këto zhvil-

TËRHIQET SUNAK! RUANDA, VIKTIMA E PARË E ZGJEDHJEVE BRITANIKE



lime thjesht mund të inkurajojnë grupet e kriminit të organizuar për të vazhduar si deri me sot, organizimin e kalimeve ilegale përmes La Manshit. Shto këtu numrin shumë të lartë, mbi 10 mijë të të ardhurve deri me sot, më shumë se çdo vit më parë në këtë periudhë kohe dhe me gjasa siç është tendenca, për

shtimin e kalimeve në muajt e verës, dhe kur vëmendja e politikës dhe shtetit është fokusuar drejt zgjedhjeve dhe fushatës elektorale.

Nëse konservatorët në pushtet humbasin, qindrat dhe milionat e dhënë Ruandës dhe gjysmë miliardët e dhënë Francës për të

penguar kalimet ne La Mansh, me shume gjasa do jenë para taksapaguesish të keqadministruar. Por edhe nëse fitojnë, konservatorët në pushtet, dhe fluturimet drejt Ruandës do rifillojnë. Fatura financiare do jete e jashtëzakonshme edhe pse nuk jepet asnjë shifër se sa mund të kushtojnë këto flu-

turime, sakaq, edhe opozita e cilëson këtë politike dështim dhe jo produktive.

Shqetësimi në radhët e opinionit publik dhe analistëve është se nuk ka drite në fund të tunelit, edhe për planet e opozitës për çështjen e emigrimit ilegal, dhe kalimet ilegale do vazhdojnë edhe pas zgjedhjeve deri në një moment të dytë politik më të qartë se kush do drejtojë vendin, dhe nëse do identifikohet dhe funksionojë një politikë anti-emigracion e cila për dekada nuk ka ndodhur dhe emigrimi drejt Britanisë nuk po njihet të ndalur, sipas shifrave zyrtare.

Deri atëherë, gjasat janë se kalimet ilegale me gomone dhe forma të tjera transportit të Britanisë, duket se do vazhdojnë dhe në rritje, siç po tregojnë muajt e parë të 2024.

HA

HARIS ALI SOLICITORS

KONSULTIMET FALAS

OFFICE: 020 8570 7300 / MOBILE: 07967 467414

We are **Immigration Experts** who have a high success rate in representing thousands of **Albanian** clients with a variety of immigration issues. We have a highly experienced team of immigration solicitors and barristers.

- Asylum / Trafficking
- Overstayers / Human Rights
- Detention & Bail
- Appeals & Judicial Review
- Fresh Claims / Further Submissions
- Indefinite Leave To Remain / Nationality
- EEA Permits / Stateless / Deprivation
- Spouse Visas / Children's Visas

Email: contact@harisalisolicitors.co.uk


19 Kingsley Road, Hounslow, London, TW3 1PA | www.harisalisolicitors.co.uk




WOODCRAFT
JOINERY LONDON

**WE BRING
YOUR DREAMS
INTO REALITY**

GLASS BALUSTRADE STAIRCASES



CLASSIC STAIRCASES




Wood Craft Joinery London
ju ofron me çmime speciale
çdo punim shkallësh



FLOATING STAIRS



MODERN STAIRCASES



MOB: 07389 164084
TEL: 020 3981 5147



**Unit 19, Woodall Road,
Enfield, EN3 4LQ**

DAUT DUTI

Gjatë qeverisjes së Benjamin Disraelit, britanikët kanë treguar një interesim mjaft të madh për çështjen shqiptare.

Por, nga ardhja e liberalëve në pushtet, që u bë në vitin 1880 në krye me William Gladstone-in, Britania e Madhe nuk ka treguar interesim për Shqipërinë apo shqiptarët. Britanikët gjatë kësaj periudhe e kanë favorizuar Greqinë dhe Serbinë.

Kjo politikë ka vazhduar 117 vite apo më saktësisht deri në vitin 1997 kur në pushtet erdhën laburistët në krye me Tony Blair-in.

Nga ky vit e deri më sot, qeveria britanike ka zbatuar një politikë të drejtë për Ballkanin në të cilën shqiptarët (Kosova dhe Shqipëria) janë vendosur në qendër, aty ku është dashur të jenë që nga Kongresi i Berlinit (1878).

Në Prishtinë sekretari i jashtëm britanik, David Cameron, ia garanton Kosovës sovranitetin kurse në Tiranë ofron ndihmë për zhvillim ekonomik, e cila gjë e integron Shqipërinë me Kosovën, por e forcon edhe rajonin. Çka duhet të bëjë më shumë një shtet mik?

Për çudi, këto premtime britanike duket se nuk krijojnë jehonë adekuate në mediat dhe publikun tonë. Ndoshta sikur britanikët të ishin kundër, mediat do të ngjallehin më shumë.

Njeriu duhet të jetë diçka më shumë se naiv për të menduar se britanikët

kanë krijuar politikë të volitshme për shqiptarët për shkak të Albin Kurtit dhe Edi Ramës. Kjo është punë më e thellë dhe më domethënëse.

Të vetmen pyetje që duhet parashtruar apo të vetmen çështje që duhet rrahur është: pse edhe shtetet tjera nuk kanë politikë të këtillë ndaj Ballkani dhe shqiptarëve, ashtu siç e

kishin nga viti 1999 e deri para pak viteve?

Një problem tjetër, që deri diku është shqetësues, është fakti se britanikët

nuk kanë interesa ekonomike në Ballkan, sikur që nuk kanë pasur asnjëherë. Ndoshta investimi në hekurudhë është shenjë e ndryshimit.

INTERESI BRITANIK PËR BALLKANIN DHE SHQIPTARËT



Urdhri i Perandorisë Britanike i jepet shqiptarit për kontributin mes dy vendeve

ARBEN MANAJ

Dr. Hoxhaj, me origjine nga Vlora, është një akademik i spikatur në fushën e Drejtësisë dhe Marrdhenieve Nderkombetare dhe Lektor në Kolegjin Universitar të Londrës për Drejtësinë, dhe me heret, në Universitetin e Warwick në Anglinë qendrore.

Medalja mbretërore e propozuar nga Lordi Cameron, Ministri i Jashtëm i Britanisë, i jepet për kontributin e tij në forcimin e marrëdhënieve shqiptaro-britanike dhe marrëveshjen e vitit 2022 me Kryeministrave Rama dhe Sunak.

Puna e tij në çështjet e luftës kundër korrupsionit, mireqeverisjen, politiken e zgjerimit Evropian dhe migrimin e të rinjve në Ballkanin Peredimor janë referuar në tre raporte hetimore parlamentare në Londer, të botuara nga Parlamenti



britanik.

Dr. Andi Hoxhaj, ka referuar për

çështjet shqiptare në disa komisione parlamentare britanike dhe është intervistuar shpesh disa nga

BBC dhe mediat britanike. Dr. Hoxhaj është aktualisht i përfshirë në promovimin dhe cuarjen për-

para të ndihmes britanike për inisiativat e drejtësisë shqiptare, të inicuar nga Lordi Cameron gjatë vizitës së fundit në Tiranë, projekt që do të lansohet javën e ardhshme në Shqipëri.

Medaljen atij ja dha në emër të Mbretit, të semurës, i biri i tij Princi Uilliam, në një ceremoni të zhvilluar në Kështjellën Mbretërore Windsor. Dr. Hoxhaj e çilon atë si nderim me të madh të jetës së tij, dhënë nga Mbreti Charles. Dr. Andi Hoxhaj, është nder me të shquarit shqiptarë të Britanisë dhe padyshim, simbol i krenarisë kombetare, sidomos për shqiptarët e Britanisë së Madhe të anatemuar shpesh padrejtësisht, vitet e fundit, nga qarqet dhe media ksenofobe britanike.

ARTE Home Furniture

NOW

OPEN



%20
WITH THIS
VOUCHER



Address: 1 Aldermans Hill, London N13 4YE

0 7447 992436

 [artehomefurniture](#)

 [artehomefurniture](#)

 info@artehomefurniture.co.uk

Anglia në zgjedhje të parakohshme Rishi Sunak caktoi datën 4 korrik

Arsyeja e ndërprerjes së vizites në Tirane të Lordit Cameron, Ministrit të jashtëm britanik, lidhet me mbledhjen e jashtëzakonshme të kesaj pasdite të kabinetit qeveritar, ku Kryeministri Rishi Sunak, njoftoi mbajtjen e zgjedhjeve të reja në 4 korrik, dhe jo në nëntor, sic është spekuluar.

Pas 14 vjetesh konservatorët e qendres së djathtë do perballen me elektoratin britanik i cili sipas sondazheve me të fundit ndodhen rreth 20 pike pas laburistëve


te opozites te cilet pritet te fitojne bindeshem keto zgjedhje. Prej mujash Sunak pat deklaruar se vendi do shkoj ne zgjedhje ne gjysemn e dyte te vitit, por refuzonte te shqiptonte nje date se kur do mbaheshin zgjedhjet.

Sipas rregullave parlamentare, duhen 25 dite nga data e shpërndarjes së parlamentit, vetëm me kërkese të kryeministrit dhe mbajtjes së zgjedhjeve.

Nderkohe udheheqesi i opozites Sir Kier Stammer ka deklaruar se në jemi gati për zgjedhjet e reja,

aq me shume pas rezultatit tejet positive te opozites ne zgjedhjet e fundit lokale te 4 majit. Sipas sondazhit me të fundit, laburistët do kenë në parlamentin e ri 443 deputetë ndërkohë konservatorët e Sunak 124.

Kujtojmë se Boris Johnson kishte vetëm 376 kur fitojte shumicën në zgjedhjet e 2019-es. Vendimi i Sunak ka surprizuar shumë brenda partisë së tij pasi ai nuk ka përbushur pesë zotimet e tij përpara zgjedhjeve të reja ku mes tyre, është edhe frenimi i kalimeve ilegale për-



mes La Manshit, ku kalimet janë rritur ndjeshëm gjatë muajve të ketij viti. Shpallja e zgjedhjeve parakohe duket me shumë si një

perpjekje për të zvogeluar përmasat e humbjes sesa si shans ideal për të fituar zgjedhjet.

AKOMA NUK KENI BUSINESS CARDS?

NA KONTAKTONI:
020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545

PËR ÇDO KONSULTIM MUND TE VINI NË ÇDO KOHË NË ZYRAT TONA
ADRESA E ZYRAVE: 30 AVENONS ROAD, LONDON, E13 8HT

BUSINESS CARDS ME QR CODE

ZGJIDHNI PROFESIONISTËT PËR SUKSESIN E KOMPANISË TUAJ

Church Court

CHAMBERS

Address
Central Court,
25 Southampton Buildings
London, WC2A 1AL
Tel: 07962336747

Services



Immigration Law

Article 8 ECHR – Family & Private Life
Asylum, Humanitarian Protection
& Discretionary Leave
EEA Law
Points Based System
Right of Abode
Citizenship
Visit Visas
Removal
Deportation
Detention
Bail
Appeals
Administrative Reviews
Judicial Reviews



Kontaktoni
Angela Sharma
07962336747

Criminal Law

Murder
Manslaughter
Terrorism
Kidnapping
Firearms offences
Robbery
Knife crime
Serious organised crime
Human Trafficking
Drug trafficking and importation
Money laundering
Fraud
Cybercrime
Sexual offences
Driving offences
Misconduct in public office
Crime with cross jurisdictional issues
Modern Day Slavery



Family Law

Child arrangements
Specific issues
Child abduction
Residence and contact
Financial Remedy
Children Public
Children Private
Domestic Violence



OKB-JA MIRATON REZOLUTËN PËR GJENOCIDIN NË SREBRENICË

Me 84 vota për, kundër 19 dhe 68 abstenime, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi një rezolutë që përcakton 11 korrikun, ditë të përkujtimit të gjenocidit të vitit 1995, kur serbët e Bosnjës vranë më shumë se 8,000 myslimanë boshnjakë në Srebrenicë të Bosnjës.

Rezoluta e hartuar nga Gjermania dhe Ruanda, që u miratua mes kundërshtimit të ashpër nga serbët, dënon mohimin e gjenocidit, një gjë që vazhdimisht bëhet nga zyrtarët serbë si në Bosnje ashtu edhe në Serbi. Ambasadorja e Gjermanisë, Antje Leendertse, tha duke paraqitur rezolutën se ajo nuk është e drejtuar kundër askujt. As kundër Serbisë – anëtare e vlefshme e kësaj organizate. Ajo shënjestron vetëm autorët e gjenocidit”, tha ambasadorja gjermane.

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vučić, tha se rezoluta është thellësisht politike. Ajo tha ai, nuk ofron ripajtim në Bosnjë dhe në rajon, përkundrazi do të thellojë ndarjet në rajon. Duke bërë thirrje për kundërshtimin e rezolutës ai akuzoi fuqitë e mëdha për trysni dhe kërcënime ndaj vendeve anëtare që nuk duan të votojnë në favor të rezolutës. Rezoluta tha ai, do të hap kutinë e Pandorës dhe do të propozohen dhjetëra rezoluta të tilla. Më 11 korrik të vitit 1995, serbët e Bosnjës pushtuan Srebrenicën që ishte shpallur zonë e sigurt e mbrojtur nga Kombet e Bashkuara dhe vranë të paktën 8,000 burra dhe djem myslimanë boshnjakë.

Vrasjet e Srebrenicës ishin kulmi i përgjakshëm i luftës në Bosnjë përgjatë viteve 1992-1995, e cila pasoi shpërbërjen e ish Jugosllavisë.

Si Serbia ashtu edhe serbët e Bosnjës

Delegacioni i Parlamentit të Serbisë, që ka marrë pjesë në mbledhjen e Asamblesë Parlamentare të NATO-s në Sofje, përmes një letre, i ka kërkuar kësaj Asambleje që të mos i japë Kuvendit të Kosovës statusin e anëtarit të asocuar.

Delegacioni serb u takua me kreun e delegacionit amerikan në NATO, Michael Turner, të cilit iu dorëzua një letër nga kryeparlamentarja e Serbisë, Ana Bernabiq. Përmes letrës, Serbia u bëri thirrje anëtarëve të Asamblesë Parlamentare të NATO-s të mos miratojnë avancimin e statusit të Kosovës nga vëzhgues në anëtar të asocuar, u tha në njoftimin e Parlamentit serb më 26 maj.

Asambleja Parlamentare e NATO-s, ku Kosova synon të avancojë statusin e saj, është institucionalisht e ndarë nga NATO-ja, por shërben si një lidhje e rëndësishme mes NATO-s dhe parlamenteve të vendeve anëtare.

Ajo përbëhet nga 281 delegatë nga të

Voting Started		5/23/2024		11:22:00 AM	
em 14 - A/78/L.67/Rev.1					
International Day of Reflection and Commemoration of the 1995 Genocide in					
AFGHANISTAN	+	CAMEROON	+	FINLAND	+
ALBANIA	+	CANADA	+	FRANCE	+
ALGERIA	+	CENTRAL AF...	+	GABON	+
ANDORRA	+	CHAD	+	GAMBIA	+
ANGOLA	+	CHILE	+	GEORGIA	+
ANTIGUA-BA...	+	CHINA	+	GERMANY	+
ARGENTINA	+	COLOMBIA	+	GHANA	+
ARMENIA	+	COMOROS	+	GREECE	+
AUSTRALIA	+	CONGO	+	GRENADA	+
AUSTRIA	+	COSTA RICA	+	GUATEMALA	+
AZERBAIJAN	+	COTE D'IVOIRE	+	GUINEA	+
BAHAMAS	+	CROATIA	+	GUINEA-BISS...	+
BAHRAIN	+	CUBA	+	GUYANA	+
BANGLADESH	+	CYPRUS	+	HAITI	+
BARBADOS	+	CZECHIA	+	HONDURAS	+
BELARUS	+	DEM PR OF K...	+	HUNGARY	+
BELGIUM	+	DEM REP OF ...	+	ICELAND	+
BELIZE	+	DENMARK	+	INDIA	+
BENIN	+	DJIBOUTI	+	INDONESIA	+
BHUTAN	+	DOMINICA	+	IRAN (ISLAMI...	+
BOLIVIA	+	DOMINICAN ...	+	IRAQ	+
BOSNIA-HER...	+	ECUADOR	+	IRELAND	+
BOTSWANA	+	EGYPT	+	ISRAEL	+
BRAZIL	+	EL SALVADOR	+	ITALY	+
BRUNEI DAR...	+	EQUATORIAL...	+	JAMAICA	+
BULGARIA	+	ERITREA	+	JAPAN	+
BURKINA FASO	+	ESTONIA	+	JORDAN	+
BURUNDI	+	ESWATINI	+	KAZAKHSTAN	+
CABO VERDE	+	ETHIOPIA	+	KENYA	+
CAMBODIA	+	FIJI	+	KIRIBATI	+
				KUWAIT	+
				KYRGYZSTAN	+
				LAO PDR	+
				LATVIA	+
				LEBANON	+
				LESOTHO	+
				LIBERIA	+
				LIBYA	+
				LIECHTENSTEIN	+
				LITHUANIA	+
				LUXEMBOURG	+
				MADAGASCAR	+
				MALAWI	+
				MALAYSIA	+
				MALDIVES	+
				MALI	+
				MALTA	+
				MARSHALL IS...	+
				MAURITANIA	+
				MAURITIUS	+
				MEXICO	+
				MICRONESIA...	+
				MONACO	+
				MONGOLIA	+
				MONTENEGRO	+
				MOROCCO	+
				MOZAMBIQUE	+
				MYANMAR	+
				NAMIBIA	+
				NAURU	+
				NEPAL	+
				NETHERLAN...	+
				NEW ZEALAND	+
				NICARAGUA	+
				NIGER	+
				NIGERIA	+
				NORTH MAC...	+
				NORWAY	+
				OMAN	+
				PAKISTAN	+
				PALAU	+
				PANAMA	+
				PAPUA NEW ...	+
				PARAGUAY	+
				PERU	+
				PHILIPPINES	+
				POLAND	+
				PORTUGAL	+
				QATAR	+
				REP OF KOREA	+
				REP OF MOL...	+
				ROMANIA	+
				RUSSIAN FED...	+
				SAN MARINO	+
				SAO TOME-P...	+
				SAUDI ARABIA	+
				SENEGAL	+
				SERBIA	-
				SEYCHELLES	+
				SIERRA LEONE	+
				SINGAPORE	+
				SLOVAKIA	+
				SLOVENIA	+
				SOLOMON IS...	+
				SOMALIA	+
				SOUTH AFRICA	+
				SOUTH SUDAN	+
				SPAIN	+
				SRI LANKA	+
				SUDAN	+
				SURINAME	+
				SWEDEN	+
				SWITZERLAND	+
				SYRIAN ARA...	+
				TAJIKISTAN	+
				THAILAND	+
				TIMOR-LESTE	+
				TOGO	+
				TONGA	+
				TRINIDAD-TO...	+
				TUNISIA	+
				TURKMENIST...	+
				TUVALU	+
				TÜRKIYE	+
				UGANDA	+
				UKRAINE	+
				UNITED ARA...	+
				UNITED KING..	+
				UNITED REP T..	+
				UNITED STAT...	+
				URUGUAY	+
				UZBEKISTAN	+
				VANUATU	+
				VENEZUELA	+
				VIET NAM	+
				YEMEN	+
				ZAMBIA	+
				ZIMBABWE	+

kanë mohuar se ka ndodhur gjenocid në Srebrenicë edhe pse kjo është vërtetuar nga dy gjykata të OKB-së. Milorad Dodiku, i cili është president i Republikës Serbe, paralajmëroi se miratimi i rezolutës mund të çojë në ndarjen e Bosnjës. Qeveria e tij tha të enjten se brenda 30 ditësh do të hartojë një marrëveshje që do t'i dërgohet entitetit tjetër të Bosnjës, Federatës së Bosnjës e Hercegovinës, për “ndarje paqësore”.

Në rezolutë është shtuar një deklaratë që thekson angazhimin e palëkundur të Asamblesë së Përgjithshme për ruajtjen e qëndrueshmërisë dhe unitetit të Bosnjës.

Milorad Dodiku është kërcënuar shpesh në të kaluarën që territoret e kontrolluara nga serbët të shkëputen nga

Bosnja dhe të bashkohen me Serbinë fqinje. Ai dhe disa zyrtarë të tjerë serbë të Bosnjës janë nën sanksionet e Shteteve të Bashkuara dhe Britanisë, pjesërisht për rezikimin e një marrëveshjeje të paqes të mbështetur nga Shtetet e Bashkuara, që i dha fund luftës në Bosnje.

Përcaktimi në vitin 2007 nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, se aktet e kryera në Srebrenicë paraqesin gjenocid, është pjesë e rezolutës. Ky ishte gjenocidi i parë në Evropë që nga Holokausti nazist në Luftën e Dytë Botërore, i cili vrau rreth 6 milionë hebrenj dhe pjesëtarë të pakicave tjera.

Ambasadorja e Gjermanisë në OKB, Antje Leendertse tha se ka një përkujtim zyrtar të OKB-së për gjenocidin

e Ruandës të vitit 1994, që ka përcaktuar 7 prillin si ditën kur qeveria e udhëhequr nga shumica Hutu filloi vrasjen e pjesëtarëve të pakicës Tutsi dhe mbështetësve të tyre. Rezoluta synon “të mbyllë hendekun” duke krijuar një ditë të veçantë të OKB-së “për të përkujtuar viktimat e Srebrenicës”, tha ajo.

Menachem Rosensaft, biri i të mbijetuarve të Holokaustit, i cili është profesor në Fakultetin Juridik Cornell, i tha agjencisë Associated Press të mërkurën se përcaktimi i 11 korrikut si ditë zyrtare të përkujtimit të gjenocidit në Srebrenicë “është një kërkesë morale dhe ligjore”.

Boshnjakët e vrarë meritojnë të përkujtohen vdekjet e tyre dhe mënyra e vdekjes së tyre në Srebrenicën që supozohej të ishte një

zonë e sigurt, por u braktis nga paqeruajtësit holandezë të OKB-së, duke i lënë boshnjakët që kërkuar strehë atje “të vriteshin nën sytë e OKB-së”, tha profesori Rosensaft.

Rusia dhe Kina, të cilat kanë lidhje të ngushta me Serbinë, kundërshtuan rezolutën.

Hungaria është i vetmi vend i Bashkimit Evropian që votoi kundër rezolutës, ndërsa Greqia, Sllovakia dhe Qiproja abstenuan.

Presidenti i Serbisë Vučić si në OKB ashtu edhe në mesin e vendeve në zhvillim për të fituar mbështetjen për një votë “jo”.

Duke argumentuar kundër rezolutës, Vučić dhe Dodik kanë përmendur mundësinë që ajo të hapë derën për të paguar dëmet e luftës nëse miratohet. Analistët vendas thonë se udhëheqësit serbë, përfshirë Vučićin, gjithashtu kanë frikë se mund të gjykohen për pjesëmarrje aktive në gjakderdhjen e Bosnjës.

Rezoluta dënon “pa rezerva veprimet që madhërojnë të dënuarit për krime lufte, krime kundër njerëzimit dhe gjenocid nga gjykatat ndërkombëtare, përfshirë ata që janë përgjegjës për gjenocidin e Srebrenicës”.

Udhëheqësi politik i serbëve të Bosnjës gjatë kohës së luftës, Radovan Karaxhiç dhe komandanti i tij ushtarak, Ratko Mlladiç, u dënuan për gjenocid në Srebrenicë nga një gjykatë e Kombeve të Bashkuara për krimet e luftës, me seli në Hagë. Në përgjithësi, gjykata dhe gjykatat në Ballkan kanë dënuar afër 50 zyrtarë serbë të Bosnjës të kohës së luftës me burgime të gjata./ VOA/

SERBIA I KËRKON NATO-S TË MOS IA AVANCOJË STATUSIN KOSOVËS

32 vendet anëtare të NATO-s.

Përveç tyre, në aktivitetet e saj marrin pjesë edhe delegatë nga 9 vende të asocuar, 4 vende të asocuar mesdhetare, si dhe 8 delegacione vëzhguese parlamentare. Anëtarët e asocuar mund të paraqesin rezoluta dhe ndryshime në rezoluta. Gjithashtu, mund të shërbejnë si raportues specialë të asocuar në komitete, për të paraqitur perspektivat e tyre në raportet NATO-Asamble Parlamentare.

Megjithatë, ata nuk kanë të drejtë të votojnë për raportet, rezolutat apo udhëheqjen e Asamblesë dhe as nuk kontribuojnë në buxhetin e saj.

Aktualisht, anëtare të asocuar janë nëntë – në mesin e tyre edhe Serbia dhe Bosnje e Hercegovina.

Kuvendi i Kosovës, prej vitesh, është delegacion vëzhgues me dy ulëse. Me ngritjen e nivelit të përfaqësimit do të zgjerohet edhe delegacioni pjesëmarrës kosovar.

Ndërkaq, në njoftimin e Parlamentit serb u tha se dhënia e një statusi i tillë do të paraqiste shpërblim për Prishtinën, e cila, sipas Beogradit, po bën gjithçka për të penguar dialogun që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian dhe për të shmangur obligimet nga marrëveshjet e arritura në Bruksel.

Siç thuhet në njoftim, zëvendëskryetarja e delegacionit serb, Natasha Jovanoviç, ia rikujtoi Asamblesë Parlamentare të NATO-s kompleksitetin e çështjes duke pasur për bazë situatën në Kosovë “pasi bëhet fjalë për shkëputje të një anshme të një pjese të territorit, të një shteti të

njohtur ndërkombëtarisht”. Sipas Jovanoviçit, çështjet territoriale duhet të zgjidhen përmes një marrëveshjeje.

Serbia po ashtu akuzoi Kosovën se po refuzon të zbatojë të gjitha marrëveshjet e arritura në dialogun në Bruksel dhe, sipas Beogradit, 11 vjet pas marrëveshjes së arritur nuk po e themelon Asociacionin e komunave me shumicë serbe.

Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje për Asociacionin më 2013 dhe 2015. Pavarësisht thirrjeve të vazhdueshme nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara, Prishtina ende nuk ka ndërmarrë hapa që të formojë Asociacionin.

Kosova humbi rastin që në mes të majit të bëhej anëtare e organizatës të Këshillit të Evropës për shkak se Aso-

ciacioni u vendos si kusht. Kosova përmes një letre dërguar kësaj organizate tha se do të dërgojë në Gjykatën Kushtetuese për shqyrtim një draft-statut për Asociacionin, në këmbim të pranimit në këtë organizatë për të drejtat e njeriut.

Kryediplotmatja e Kosovës, Donika Gërvalla, tha se draft-statuti do të frymëzohej nga ai që ka paraqitur organizata gjermane Friedrich-Ebert-Stiftung, e jo draft-statuti që iu paraqit Kosovës dhe Serbisë nga BE-ja tetorin e vitit të kaluar.

Por, Kosova nuk u fut në agjendën e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës që u mbajt më 16 dhe 17 maj në Strasburg. Megjithatë, Këshilli i Evropës ka thënë se po e shqyrton mënyrën se si të procedojë me rastin e Kosovës. (Radio Evropa e Lirë)



-Green Basket është për shitje

-Përballë stacionit të trenit në Wood Green

-Me një sipërfaqe shumë të madhe dhe me bodrum poshtë

-Mundësi për ta shndërruar në restorant etj etj

-Çmimi shumë i arsyeshëm

**Për më shumë info tel:
07883 027133**



KIM MEHMETI

“SHQIPËRITË” TONA KALBEN NGA BRENDA!

Nëpër “Shqipëritë” tona çdonjëri flet me të ngjashmit me vetveten. Kështu opinionistët tanë i vlerësojnë të gjithë të tjerët, përpos vetveten, filozofët debatojnë me njëri tjetrin për fe e xhami, por jo për urtësi, klerikët flasin mes veti për moral e familje, por duke mos u penguar kur feja bëhet ‘shërbëtore’ e politikës...

Pra ne jemi mbyllur çdonjëri në rrethin e vet, ku debatojmë dhe flasim për tjetrin, por jo edhe me të tjerët. Me çka “Shqipëritë” tona u bënë shoqëri të “hapura” të përbëra nga rrethe të mbyllur.

Shkurt e shqip: nëpër “Shqipëritë” tona mungon komunikimi ndërqytetarë andaj ka protesta partiake, protesta të mjekëve, të studentëve, të bujqve..., por jo edhe protesta ku të gjithë së bashku do e luftonin hajdutërinë dhe krimin që i ka mbuluar

shoqëritë tona.

Po pra, nëpër “Shqipëritë” tona të gjithë janë mbyllur brenda llojit të vet dhe nuk bashkëbisedojnë me të tjerët, por e vlerësojnë tjetrin. Duke harruar kështu se çdo gjë e mbyllur, që nuk ajroset nga jashtë, fillon të myket dhe të kalbet.

Si dhe duke mos vërejtur se edhe “Shqipëritë” tona thuhet kanë nisur të “kalben” nga brenda, të bëhen vende ku një budalla përfaqëson mijëra të mençur, ku një hajdutë vendosë për fatin e qindra të ndershmeve dhe ku vriten më



të vlefshmet që kemi – ëndrrat dhe shpresat rinore.

Piktori i përbuzi të gjithë votuesit e Kurtit!

Edhe sikur të ishte rrugaç, e jo më Kryeministër i këmbë që t’ia shtrinte dorën qoftë edhe një lyp-sari që i afrohet ta përshëndesë, e jo më Kryeministrit të Kosovës. Por Piktori nuk është rrugaç, e siç duket as Kryeministër, por vetëm një delirant që e shpërfaq mjerimin politik të shqiptarisë. Dhe nëse e vëreni si është shtrirë në

kolltuk, do mund ta lexoni pse nuk çohet dhe cilën porosi ua përcjellë votuesve të Kryeministrit të Kosovës – përbuzjen!

Pra nëse e vëreni kujdesshëm qëndrimin e tij përderisa i afrohet Kryeministri i Kosovës, do mund ta shpalosni se ai ndjehet si drejtues i një populli me elita pa ndërgjegje, andaj edhe nuk ka frikë që paburrërinë e vetë ta shpallë si ves mbarë shqiptarë. Diku mes këtyre dy të vërtetave qëndron ajo më e dhimbshme: ndaj Kryeministrit të Kosovës Piktori sillt siç nuk do sillte as një funksionar i Beogradit, mbase pse edhe ai, njësoj si gjithë burrëshetësit serb, nuk mund ta imagjinojë se mund të ketë politikan të mençur dhe me dinjtet shqiptar nga Kosova, i cili do guxonte t’i kundërvihet Serbisë?!

AKOMA NUK KENI BUSINESS CARDS?

NA KONTAKTONI:

020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545

PËR ÇDO KONSULTIM MUND TE VINI NË ÇDO KOHË NË ZYRAT TONA ADRESA E ZYRAVE: 30 AVENONS ROAD, LONDON, E13 8HT

The collage includes cards for:

- FD CONSTRUCTION**: Over 18 years of experience in building and refurbishment works. Phone: 020 3788 7119.
- LEO'S BAR & GRILL**: AUTHENTIC MEDITERRANEAN CUISINE. Phone: 020 3788 7119.
- K ROOFING LTD**: NEW ROOF-LEAD WORK-FLAT ROOF. Phone: 07927 214785 / 07477 867332.
- E&G STEELFIXING**: ADDRESS: 31 CROMWELL CLOSE EAST HINCHLEY WOOD. Phone: 07595 575280.
- TUSHA CONSTRUCTION**: THE BEST OF CONSTRUCTION. Phone: 07492 248409.
- B&B LONDON CONSTRUCTION LTD**: More information: 08002484752.
- OUR SERVICES**: Over 18 years of experience in building and refurbishment works. Includes New Build, Loft Conversion, Extension, Kitchen and Bathroom, Paving & Landscaping.
- WE OFFER**: New Roof, Lead Work, Felt Torch Roofing Systems, Liquid Roofing Systems, New Gutter, New Fascia & Soffit, Roofing, Repairs.
- Services**: Concrete Structures, Columns & Walls, Concrete Slabs, Steel Fixing, Fabrication, Mesh, Ground Beams.
- OUR SERVICES**: Loft Extension, Refurbishment, General Building Work. Phone: 07492 248409.
- OUR SERVICES**: CIVIL ENGINEERING & GROUNDWORKS, PAVING & LANDSCAPING, DRAINAGE, DRIVEWAYS & PATIOS, DEMOLITION. Phone: 07492 248409.
- Our Services**: LOFT CONVERSION, EXTENSION, FULL REFURBISHMENT, PLUMBING & HEATING.
- Our Services**: Temporary Roof Systems, Gantry's and Loading Bays, Painters Scaffolds, Access Towers, Chimney Stacks, Pavement Scaffolds, Birdcages, Internal High Status Scaffolds, Bricklayers Scaffolds.
- A&D CONSTRUCTION LTD**: 7 St Pauls Mews, Crawley RH10 1DR. Phone: 07590 008835.
- JD CONTRACTORS**: We have more than 10 years of experience in the building industry. Phone: 0786282088.
- A&O SCAFFOLDING LTD**: Contact Us: Mob: 07552585665, Mat: 07533964532.
- OUR SERVICES**: Temporary Roofs, Domestic Scaffolding, Industrial Access, Competitive Rates, Professional and experienced Scaffolders, Personalised services, All scaffolding work undertaken.
- BKB LANDSCAPE LTD**: 42 Devenay Rd, London, E15 4AY. Phone: 07450211425 / 07727635228.
- ART CONSTRUCTION GROUP**: DREAM IT - REALISE IT - BUILD IT! Phone: 07476768895.
- Services**: EXTENSIONS, KITCHEN & BATHROOM REWIRING, ELECTRICALS, PLUMBING & HEATING, COFFER BEAMS, SALOONS, RESTAURANTS. Phone: 07426 755312.
- Services**: LANDSCAPING, PAVING, DECKING, FENCING, BRICKS, SLABS, ARTIFICIAL TURF ETC. Phone: 07506 864 035.
- LALA SCAFFOLDING LTD**: Southern Arden Road Harnchurch. Phone: 02071 129374.
- OUR SERVICES**: REFURBISHMENT, EXTENSIONS & LOFT CONVERSIONS, GROUNDWORKS & FOUNDATIONS, NESSAL ROOF, TILING, PAINTING & DECORATING, CARPENTRY, ELECTRICAL & PLUMBING, PAVING & LANDSCAPING, ROOFING, BRICKLAYING, STEELFIXING. Phone: 07476768895.

BUSINESS CARDS ME QR CODE

ZGJIDHNI PROFESIONISTËT PËR SUKSESIN E KOMPANISË TUAJ

DAUT DAUTI

Tulipani është simboli i rritjes së fuqisë së Perandorisë Otomane. Kjo lule ka qenë subjekt i shumë poezive të hershme të dashurisë dhe bukurisë në literaturën perse.

Prandaj, aristokracia otomane e solli këtë lule në Stamboll. Sulltanët bënëin garë se cili po e stoliste pallatin perandorak dhe parqet publike më mirë dhe me më shume lloje të tulipanëve. Sulltan Sulejmani i Madhërisëm u bë kampion i kultivimit të tulipanit. Madje, ai edhe çallmën e dizajnoi me pamje të tulipanit.

Në fakt, në persisht dhe osmanisht fjala 'tulipan' është për 'turban' që shqip është 'çallmë'.

Për ta kuptuar rëndësinë e kësaj luleje në Stamboll e gjetiu në perandori, duhet patur parasyshë thënien që qarkullonte atëherë e që thoshte: një tulipan është më i vlefshëm se jeta e një njeriu.

Sidoqoftë, sulltan Sulejmani një ditë ia dhuroi disa kokrra apo fara fisnikut



flaman, Olgier de Busbeck, i cili shërbente si përfaqësues diplomatik i habzburgëve në pallatin perandorak

otoman. Pastaj, Busbeck ia dha disa tulipanë mikut të tij, Carolus Clusius-it, i cili e dekoroi kopshtin perandorak

në Vjenë. Por, pas disa viteve, Clusius duke qenë botanist i njohur, u emërua profesor në Universitetin e Leidenit

FUQIA E TULIPANIT

(Holandë) dhe me vete i solli farat e tulipanëve.

Ky veprim i profesorit krijoi histori. Tulipani në Holandë u bë aq i rëndësishëm sa që njerëzit e përdornin, jo vetëm si lule, por edhe si mjet pagese. Shitblerja e tulipanëve e krijoi tregun e parë spekulativ në Evropë dhe poashtu ndikoi edhe në rregullimin financiar, tregtar sikur edhe bankar.

Sot, Tulipani është lule e shpërndarë në botë, por lidhet gati tërësisht me Holandën. I shohim gjithë ato fotografi të bukura të arave të rrafshta holaneze me lloj lloj ngjyra të tulipanëve.

Duhet theksuar se një lloj tejet i veçantë i Tulipanit, i quajtur 'Tulipa Albanica', rritet në Shqipëri, më saktësisht në një vend në rrethin e Kukësit. Botanistët bëjnë me dije se kjo lule autoktone është në rrezik të zhdukjes.

ANDI BUSHATI

Rritja e statistikave të të arrestuarve nga SPAK, në mënyrë krejt paradoksale, po zhbën ditë pas dite arsyen për të cilin ky institucion u ngrit. Sa më shumë vjedhje kolosale apo skema vrasjesh kriminale që zbulohen, aq më tepër mpaket besimi i publikut se pandëshkueshmërisë po i vjen fundi.

Këtë dëshmoi edhe dosja e radhës për aktivitetin e disa prej bandave më të rrezikshme të vendit, që operonin në zonën mes Lezhës, Laçit, Fushë Krujës dhe Tiranës.

Çfarë gjejmë aty? Një ish-deputet të PS-së, Arben Ndoka, që për muaj të tërë angazhon një ushtri me vrasës, për të kryer një krim. Një përfaqësues të Rrajave, klanit tjetër të një ish-deputeti rilindas, i cili organizon një pritë për vrasje, këtë radhë kundër vetë Arben Ndokës.

Pastaj në skenë del Astrit Avdyli, personazhi i dosjes 339, i bërë i famshëm nga përgjimet e Bild, që prej qelive të parburgimit kontrollon killerrat me pagesë. Më tej Pëllumb Gjoka, siguresi i hambarit të votave në Qarkun e Shkodrës, që është i aftë të rekrutojë



shefa policie, për të vazhduar aktivitetin ilegal të lojrave të fatit. Më tej, njeriu i afërt i drejtorit të përgjithshëm të policisë, Ardi Veliut (çuditërisht përmendet me emër në dosje), që gënjeu publikisht për krimin elektorat të Elbasanit, i cili spi-

unon për llogari të grupeve mafioze.

Po ta vështrosh nga një këndvështrim ku SPAK refuzon të thellohet, të gjithë këta elementë i lidh një gjë e vetme. Ata, në një mënyrë ose në një tjetër, kanë prodhuar vota për partinë

në pushtet. Dhe ky dyshohet se ka qenë çeku i bardhë për të pasur liri në aktivitetin e tyre kriminal.

Kur ndjek këtë logjikë, natyrshëm të vjen ndërmend pyetja: Po a shkon dot Prokuroria e Posatçme tek ata që ia falën killerave këtë liri? Ai i prek dot ajo krimet elektorale që kanë rrënjosur pushtetin e një bande të vetme?

Mjafton të ngresh këtë dilemë për të kuptuar se në mënyrë krejtësisht kontradiktore, SPAK-u, aq sa po e rrënon moralisht këtë qeverisje, duke nxjerrë në shesh të vërteta që as imagjinata më perverse nuk do të kish mundur t'i fantazonte, po aq dhe po e përforcon pushtetin e saj, duke mos i prekur thelbin e ekzistencës.

Ky konkluzion po aq sa është i vërtetë i për aferat kriminale, vlen njësoj edhe për ato korruptive. Po të zhytesh në skandalin e inceneratorëve sheh se prokurorët dhe hetuesit kanë gjurmuar ata që kanë çuar ndonjë lekë në shtëpi, që kanë përfituar ndonjë biletë udhë-

timi apo shtrat erotik hoteli, ndërkohë që nuk kanë guxuar të zbardhin arkitekturën mostrooze të grabitjes që në fund do ti kushtojë shqipëtarëve afto gjysëm miliardi euro. Pra edhe këtu SPAK-u njollos, bën pis, përforcon bestydninë kolektive të një populli që vidhet përditë, por nuk është në gjendje t'i japë përgjigjen se cilët janë hajdutët e vet realë.

Pikërisht ky paradoks, ku pikturohet përmes faktesh të panumërta se po bëhet batërdia, por ama ka e keqja sistemike mbetet pa kokë, po rrëndon përditë e më shumë besimin tek një institucion që u ngrit me shpresën se të paprekshmëve do i vinte fundi.

Për të perifrastuar një shprehje të një prej përkrahësve fillestarë të tij, ish ambasadorit Donald Lu, SPAK nuk po shkon dot tek peshqit e mëdhenj. Ai po kënaqet duke bërë statistikë me cironka, prandaj dhe krimi dhe korupsioni bëhen më të fortë, ndërkohë që rrjeta duket e mbushur plot me të arrestuar./LAPSI

NA GJENI NA FACEBOOK
KERKO THE ALBANIAN
MBI 1 000 000 NDJEKES

ENVER ROBELLI

Për Asociacionin, konspiracionet dhe kurthin që klasa politike e Kosovës ia ngriti vetes

Duhet mbase një kronologji për të parë përse shumë çështje e punë të Kosovës nuk po ecin mbarë. Më 2015: Dështon pranimi i Kosovës në UNESCO për tri vota. Mes shteteve që nuk e përkrahën Kosovën kishte edhe të tilla që e kishin pranuar pavarësinë e Kosovës. Më 2018: Dështon pranimi i Kosovës në Interpol pasi vendi nuk arriti të siguronte dy të tretat e votave. Më 2024: Dështon anëtarësimi i Kosovës në Këshillin e Evropës (për shkak se nuk futet në rend të ditës).

Si sot, si atëherë përgjegjësit politikë i kanë arsyetimet pothuaj të njëjta: bëmë gjithçka, por fushata agresive e Serbisë... etj. etj.

Problemi është pak më i ndërlikuar. Kur hidhni nënshkrime në emër të shtetit (si më 2013, 2015 apo në raste të tjera), atëherë merrni obligime në emër të shtetit, pra kjo ka pasoja politike dhe juridike. S'ka lidhje kush është në pushtet, pasojat apo efektet mbesin dhe me to duhet të merret çdo qeveri për aq sa problemi nuk zgjidhet. Kur si zyrtarë shteti nënshkruani diçka me bindje, atëherë me po aq bindje duhet ta mbron, nuk mund të dilni e ta bëni të kundërtën e asaj që keni nënshkruar. Ose mund ta bëni, por kjo ka pasoja. Dhe është tallje me qytetarë dhe me mbarë botën.

E vërtetë: Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka thënë më 2015 se plani për "bashkësinë e komunave serbe" në shumë pika bie ndesh me Kushtetutën. Por Gjykata Kushtetuese po ashtu ka thënë: duhet gjetur zgjidhje duke i marrë parasysh vërejtjet e Gjykatës Kushtetuese. E çka ka bërë klasa politike e Kosovës që gati 10 vjet? E ka kaluar duke prodhuar mjegull.



Të gjithë ne që me vite e kemi theksuar këtë çështje, pra se duhet gjetur një zgjidhje - ose jemi injoruar, ose jemi stigmatizuar, ose etiketuar me epitete jo aq pozitive. Ky është problemi më i vogël, halli më i madh është refuzimi i klasës politike për t'u marrë me problemin. Ajo pjesë e klasës politike që e nënshkroi marrëveshjen e vitit 2013 praktikisht hoqi dorë prej saj duke e konsideruar si rrezik për krijimin e një "republike serbe" dhe filloi të ndjekë projektin tjetër për "korrigjim kufijsh". Kjo qasje ia rriti ambiciet Serbisë. Opozita e atëherëshme (sot në pushtet) iu qas problemit me mungesë ekstreme të realizmit, me refuzim radikal dhe me premtime fluturuese.

Asnjëra qasje s'po funksionon dhe për këtë ka pasur paralajmërim si ky në vijim (citat nga kolumna ime e botuar më 6 korrik 2022 te "Koha"): "Guri

më i rëndë mbi shpatullat e Kosovës është 'Bashkësia e komunave serbe'. Ky projekt politik është shpallur pjesërisht kundërkushtetues nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës, por vetëm pjesërisht, jo tërësisht. Rrjedhimisht, kjo qeveri, herët apo vonë, duhet të merret me këtë projekt që e ka trashëguar nga pushtetet e kaluara. Siç duhet të merret edhe me vendimin e drejtësisë kosovare për disa hektarë që parashihet t'i jepen Manastirit të Deçanit, bazuar në një vendim të një gjykate arbitrare serbe të marrë në fund të viteve '90."

Sjellja sikur problemi nuk ekziston, e ka futur Kosovën në qorrrokak. Si të dilet nga ky qorrrokak?

Në një shoqëri të polarizuar thellësisht, ku mosdurimi ndaj njëri-tjetrit shkon deri në urrejtje patologjike, ku "debati publik" i ngjan garës së der-

rave në sheshin e katundit, ku ekzekutimi në trekëmbëshin digjital i çdokujt që s'vrapon me turmën tashmë është bërë ritual makabër, ku mendësia fisnore errëson logjikën shtetërore, ku çdo kompromis shihet si dobësi, ku kundërshtari politik është i dobishëm vetëm kur keqpërdoret për makinacione e kurthe politike, ku cinizmi zëvendëson argumentet, ku sulmet ad hominem mëtojnë të dehumanizojnë atë që mendon ndryshe, ku faktet përdridhen sipas interesit momental, ku betejet për pushtet zhvillohen edhe me kosto në dëm të shtetit, ku punët e shtetit janë improvizim, ku papjekuria e bartësve të posteve të rëndësishme merr përmasa fabulash, ku politikanëve u mungon guximi për të marrë përgjegjësi për vendime të vështira, sepse mendjen e kanë të fushata elektorale - në një shoqëri të tillë stagnimi është rregull, jo përjashtim.

E tash? Pse nuk e di opinioni i Kosovës ende përmbajtjen e plotë të propozimit që paskësh bërë emisari i BE-së për Bashkësinë e komunave serbe? Apo betimi për transparencë vlen veç në fushata elektorale, pastaj harrohet? Nëse po refuzohet, le të dihet çka po refuzohet. Dhe le të mbajnë qëndrim të gjithë për këtë, hapur, publikisht, jo duke u fshehur pas mjegullës që po prodhohet që 10 vjet. Nga pushtetet dhe opozitat e deritanishme. Dhe nga militantët dhe borizanët e tyre. Mund të thuren 1001 konspiracione, jo na e bëri ky, jo na e bëri ai (përralla për Twitter e Facebook janë këto), por në fund dhe më e rëndësishmja: Kosova duhet të sqarohet me vetveten dhe ta pastrojë oborrin e vet. Sepse këtë kurth klasa politike ia ka ngritur vetes: njëri krah me axhamillëk

kolosal ("marrëveshje historike", "Serbia e pranoi de facto Kosovën"), tjetri krah me premtim se do ta rrotullojë botën sapo të marrë besimin e popullit. Shkopi magjik nuk ekziston askund, rrjedhimisht as në politikë. Nga jashtë fabrika e suxhukut duket e bukur, por kur e shikoni nga brenda si prodhohet suxhuku...

Pra, Kosova duhet ta pastrojë oborrin e vet. Jo me aksione të pamenduara dhe të nisura 10 minuta para finisht. Jo me vajtime. Jo me ikje në formalizma e folklorizma. Mungesa e një konsensusi sot për një çështje kaq të rëndësishme si Asociacioni, mund të rezultojë me një faturë të shtrenjtë nesër për të gjithë.

Nga përvoja e deritanishme si vëzhgues i këtij problemi që po e shoqëron Kosovën prej vitësh, nuk jam shumë optimist. Duket sikur krejt spektri politik është kurthuar pavetëdijshëm në çështjen e Asociacionit, sepse kjo çështje i plotëson krejt kriteret për t'u sharë me njëri-tjetrin, për t'u akuzuar e kundërakuzuar për tradhti e komplete dhe për t'ia dëshmuar njëri-tjetrit sa patriotë të mëdhenj jemi. Dhe në fund pa marrë asnjë vendim nga ata që duhet të marrin vendim.

Kjo paralizë shoqërore po zgjat që më shumë se 10 vjet. Ata që janë lindur më 2013, tash hyjnë në pubertet. Dhe pas tre-katër vjetësh mund të jenë ose kamerierë në Berlin, ose punëtorë ndërtimtarie në ndonjë kantier në Kroaci. Por neve s'po na bëhet vonë për asgjë. Jemi të lumtur në bahçen tonë, duke u gjuajtur mes vete me pemë të kalbura.

KOHA

POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazon biznesin tuaj

Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners



Adresa e zyrave:
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:
020 7018 7929
073 4066 5946



AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

E nesërmja fillon tani!

Dotech
websites 

Jepi frymëmarrje biznesit tuaj!


Adresa e zyrave
30 Avenons Road
London E13 8HT

Për çdo konsultim mund te vini
në çdo kohë në zyrat tona

Dotech
websites 

Na kontaktoni:
020 7018 7929

Mob:073 4066 5946 Mob:078 5997 7545



XHEVAT MUSTAFA

“O SA MIRË” APO “O SA TURP” ME QENË SHQIPTAR!?

Në kohën e pushtimeve shekullore romake, serbo-bullgare, turke, austriake, greke, italianegjermane si dhe gjatë 47 viteve të pushtimit komunist-enverian, shqiptari justifikohet se bëhej ushtar, shërbëtor, spiun i pushtuesve dhe diktatorëve, sepse do të siguronte kokën, bukën e gojës, familjen, shtëpinë, pronën...! Këto 10 vjet të Edi Ramës me shoqe e shokë si vetja që i mbështet, duartroket, voton, deri në Athinë i shoqëron... dhe si skllav apo lepur i duron, për të gjitha të zezat, që prej tyre përjeton, se “do të mbrojtë vendin e punës dhe karrigen e sumës...”?! Kanë pasur shumë të drejtë Konica e Fishta në çaste zhgënjimi, mërzie, revoltimi... që kanë shkruar ca të vërteta të rënda, por ama të sakta për shqiptarin, fatalisht e historikisht, me mbizotërim maksimal demografik atë fshatarin...! Kjo pjesë e popullit, viktimë e “viruseve” të sjellë nga pushtuesit, nga analfabetizmi dhe injoranca masive, nga konservatorizmi e fanatizmi... kanë qenë mall tregu si prodhimet e fushës e të bahçes, edhe vetja, edhe vatani, edhe vajza!

Sipas këtyre kolosëve, ai i ka marrë e i merr gjak në vetull më së shumti shqiptarit dhe i ka bërë gjëma vetes dhe vatanit, ndoshta më shumë se pushtuesit dhe sunduesit. Edhe më rëndë e më për t'u turpëruar, disa nga pushtuesit janë befasuar e kanë thënë e shkruar se në Shqipëri i kanë gjetur spiunët më me shumicë, falas ose fare lirë më tepër se në vendet e tjera!? Mjafton t'i referohemi traditës së gjakmarrjes, disiplinuar ndjeshëm e gjatë me Kodin e Lek Dukagjinit, por fatkeqësisht i cenuar në shtyllat dhe ligjet e tij kryesore, sidomos gjatë 450 viteve të pushtimit turk dhe në këta 80 vitet e fundit! Shqiptari, referuar edhe rastit fare të freskët, të dt.13 maj 2024, të vrasjes së policit në Fier, ka vlarë e vret për hakmarrje e jo burimisht, por pas shpine e në prita të fsheshta pas gardhit, ledhit, shkëmbit, trugut të një druri apo peme, pas avlisë, në një cep fushë mbjellë me misër, grurë, tagji ose pas një mullari!

Në këto “vite moderne” ca shqiptarë të sotëm të vrasin me plumba apo tritol, me maska, nga brenda ose pas veturave të shpejta e të shtrenjta!? Për më tepër e më keq, jo rastësisht, krejt ndryshe nga italianët, francezët, spanjollët, gjermanët, anglezët, nordikët, rusët... që bënin duele burrërore me shpata e pistoleta! Duke e konkretizuar nga jeta e përditshme, plot shqiptarë që kanë pushtuar tri nivelet e prodhimit e të tregjeve; të furrave të bukës, të dyqaneve të bulmetit, mishit, të fruta-zarzavateve; të restoranteve, hoteleve, jo rastësisht shumica pronarë me origjinë fshatare e ish-punonjës në Sigurimin e Shtetit, ushtarakë në Ministrinë e Brendshme e të Mbrojtjes e në zyra partiake dhe qeverisëse të kohës së Enver Hoxhës dhe Ramiz Alisë, duke lakmuar e



menduar vetëm që të fitojnë vetë e familjarisht sa më shumë, bëjnë të 99-tat e pislleqeve në përbërjen, cilësinë, çmimet e artikujve ushqimorë; të farmaceutikës, higjienës dhe kozmetikës; të ndërtimit dhe të atyre hidraulikë; të veshjeve dhe mobilierisë... Domethënë, nuk mendojnë fare ose mendojnë fare pak se duke prodhuar e shitur mallra me hormone, kimikate dhe për më keq me doza shumë përtej normave të lejuara ose me javë, muaj e vite të skaduar, rrezikojnë shëndetin, jetën, buxhetin, mbijetesën e blerësve e të konsumatorëve, edhe të atyre me të cilët mund të kenë lidhje farefisnie, miqësie, shoqërie, pune, komshillëku... Këta nuk vrasin drejtpërdrejtë, me kallashnikovë, pistoleta, tritol e thika, por gjithsesi “vrasin” për ditë e ngadalë me ato që prodhojnë e shesin, për më keq, shumicën me çmime më të lartë edhe se në Greqi, Itali, Gjermani, Francë...!

Është bërë e qartë se jemi shumë të vonuar të reflektojmë ndaj sugjerimit apo këshillës së plot miqve ndërkom-bëtarë, por edhe shqiptarëve të emancipuar, që të jemi më të përbajtur e më të sinqertë, së pari me vetveten. Që edhe mburrjet është mirë të jenë me masë e jo me thasë, ashtu si kripa në gjellë e sheqeri në kafe! Kjo nënkupton edhe sugjerimin që, për çka kanë bërë të keqe, të pistë, të turpshme, të përgjakshe... ca shqiptarë të vjetër e të rinj në Shqipëri e nëpër botë, duke turpëruar edhe Skënderbeun, Isa Boletinin, Nënë Terezën,

Adem Jasharin... e të tjerë shqiptarë të vërtetë, të pushkës, të penës, të skenës, ekranit, stadiumeve, thirrjes sonë ulëritëse dhe “dehëse” nëpër stadiume dhe manifestime festive e partiake, nëpër këngë tallavashë me doza të forta turqizimi e serbizimi, “O sa më mirë me qenë shqiptar”, t'i shtohet edhe pjesa “O sa turp me qenë shqiptar”! Se jemi të pashoq për t'u lehtë mashtruar apo lumturuar nga gënjeshttrat sy më sy nga padronët, partitë dhe kryetarët e zemrës, nga sloganet dhe shifrat droguese të tyre si dhe nga ca “legjenda e përralla” historike e gjuhësore, e shpreh edhe fakti se në vende të Perëndimit, të paktën 50 vjet më përpara e më lart nesh për nga të gjithë standardet dhe treguesit, nuk dëgjohen njerëz apo kore masivë që të thonë me zëra normalë e jo më të ulërijnë si në shqiptarët “o sa mirë me qenë anglez”, “o sa mirë me qenë italian!”, “o sa mirë me qenë gjerman!”, “o sa mirë me qenë zviceran!”, “o sa mirë me qenë francez!”, “o sa mirë me qenë danez!”... Nuk e bëjnë këtë edhe pse kanë shumë arsye e të drejtë, shumëfish më tepër se ne, prej 112 vitesh ndër më të varfrit jo vetëm të Evropës që të mburren para nesh e para mbarë botës.

Paradoksi edhe pasinqeriteti ynë bëhen më të fortë kur mburremi edhe para atyre popujve që prej mbi 100 vjetësh na kanë hapur dyert e kufijve, të porteve, aeroporteve... për të na lejuar të jetojmë e punojmë si emigrantë në vendet e tyre, për të shpëtuar nga jeta e ferrshme 80- vjeçare në

Shqipëri e si shqiptar, për të cilën po vetë kemi gjetur cilësimin e saktë e shprehës “jetë allashqiptare”...! Me një dozë të lehtë humori, tolerance apo kompromisi mund të pranohet si më e drejtë që slogani “O sa më mirë me qenë shqiptar!” të formulohet pak më ndryshe!

Një nga variantet alternativë mund të ishte “O sa mirë me qenë shqiptar gruaja, djali, vëllai, miku, shoku... i kryeministrit; oligark, “investitor strategjik”, deputet, ministër, zv.ministër e këshilltar e sekretare e tyre, drejtor i përgjithshëm, kryetar bashkie, gjykatës, prokuror, doganier, tatimor, mjek dhe infermiere, akademik i Skënder Gjinnushit...”! Një variant tjetër mund të ishte: “O sa mirë me qenë shqiptar në Greqi, Itali, Zvicër, Gjermani, Austri, Holandë, Belgjikë, Francë, Danimarkë, Finlandë, Suedi, Norvegji, Islandë, Kanada, SHBA, Zelandën e Re, Australi...”!

Një popull që nuk bindet për 80 vjet se ka besuar, mbështetur, votuar një parti gjase komuniste e socialiste dhe gjase shqiptare, që e ka mashtruar, torturuar, vjedhur sy më sy apo nën hundë..., që i ka nxi jetën dhe Shqipërinë, sa në këta 34 vjet të ikë nga sytë këmbët e me çdo faturë nëpër vende të Perëndimit kapitalist, si mund të identifikohet, etiketohet, vlerësohet, quhet... As i mençmi, i afti, i miri dhe i dobishmi për vete, familje, vend, komb, botë dhe as injoranti, keqdashësi i vetes, familjes,

fshatit, qytetit, vendit..., kombit..., nuk kanë as damka në gjoks e ballë e as brirë mbi kokë...! Nuk rrahin as gjokse sa t'i bëjnë gropë apo plagë duke u mburrur dhe duke mashtruar veten me përralla e premtime, që nuk i besojnë as fëmijët 2-3 vjeçarë dhe as pacientët e pashërueshëm nëpër spitale psikiatrikë...! Pra, çfarë populli jemi ne? Të zgjuar “sa nuk na e ha qeni shkopin” apo naivë “sa i fusim në gojë qenit” jo vetëm shkopin, por edhe dorën, deri në sup... dhe foshnjën e porsalindur...?

Koha dhe gjendja kritike si vend e si popull shtron si detyrë urgjente që historianët, filozofët, psikologët, sociologët... jo detyrimisht e jo ekskluzivisht me titujt e fituar nga Akademia e Shkencave të Enver Hoxhës, Ramiz Alisë, Skënder Gjinnushit... të mblidhen, studiojnë dhe analizojnë përse edhe pas 112 vjet shtet dhe pavarësi, me pasuri të mëdha nëntokësore, me mrekulli natyrore, me rreth 270 ditë me diell dhe temperatura për të bërë plazh në dy detet e në shumë liqenet që na ka fal natyra apo Zoti, Shqipëria është në këtë gjendje e me këto standarde. Konkretisht dhe fare shqip: ndër të fundit për tregues të lartë zhvillimi, mirëqenieje, demokratizimi, shteti ligjor e drejtësie të pavarur dhe ndër të parët apo kampionë vetëm për të këqija, për varfëri, korrupsion, emigracion, kanabizim, kullëzim për shpëlarje parash të pista, për prostitucion...!

Njëherazi, edhe për të gjetur rrugët se si mund të dalim nga kjo humerë, ku na kanë gremisur turqit, serbët, grekët, rusët... Por edhe vetvetja, nëpërmjet disa liderëve apo udhëheqësve, që i kemi nderuar, ndjekur, mbështetur, votuar... verbërisht, edhe pse është kuptuar se kanë punuar vetëm për plotpushtetizimin dhe pasurimin e tyre personal dhe familjar, si dhe për “tufat e shërbëtorëve”, të drejtorëve dhe drejtoreshave, të këshilltarëve dhe sekretarëve e të këshilltareve dhe sekretareve... Por, edhe më rëndë e më keq, duke parë me sytë e mendjeve se kanë qenë e janë më shumë misionarë të mirëpaguar të këtyre armiqve shumë shekullor se sa shërbëtorë të pavullnetshëm e të detyruar nga “laku në fyt” apo “plumbi në lule të ballit” për secilin prej tyre. Në qoftë se arrijmë të dalim nga kjo humerë apo gjendje, e krahasueshme vetëm me atë të vendeve më të pazhvilluara në Afrikë, Azi, Amerikën Latine..., me mbizotërim rreth 112-vjeçar të së keqes e 80-vjeçar të “së majtës” dhe futemi në “rrugën e Zotit” e të “Evropit”, atëherë do të kemi shumë të drejtë të mburremi deri sa t'i bëjmë gjokset gropë a plagë e të ngjiremi: “O sa mirë me qenë shqiptar”!

LUTFI DERVISHI

Në dosjen Metamorfoza 2 ku shfaqen figura të njohura të botës së krimit dhe politikës flitet për marrje peng, nxjerrje në pritë, vrasje dhe biznes.

Po çfarë mungon në 240 faqet e akuzës?
Mungojnë dialogjet për zgjedhjet dhe komunikimet me politikanët.

Nëse themi se bandat janë përfshirë në zgjedhje me nxitje, bekim dhe mbeshetje politike nuk kemi thënë asgjë të re.

Po pse janë veçuar rrefimet dhe kontributet politike të 50 të akuzuarve në politikë?

Cila është arsyeja që hetimi është ndarë në lote?

Një vit para zgjedhjeve SPAK mund të jepte një kontribut konkret duke hetuar përfshirjen në fushatë të "biznesmenëve, Investitoreve strategjikë, alias vrasesve me pagesë.

Ky hetim do të jepte shpresë se krimi zgjedhor më 2025 do të ulte pak kokën.

Është më shumë se naivitet të mendosh se në bisedat e tyre nuk është folur për politike, për zgjedhje, për votime dhe për emëtime.

Njerëz që diktojnë drejtore policie dhe kryetare bashkie afërmendsh që janë investuar në fushata.

Disa prej të akuzuarve janë të njëjtët personazhet të përfshirë në krimin zgjedhor në Durrës dhe Diber. Prokurorët e SPAK treguan mungesë kurajo duke bërë ping pong me Prokurorinë e Dibres (dosja 188) derisa arriten t'ia ngecin asaj hetimit që u katandis si kokoshi një thelë.

Ashtu si në dosjen e incineratorëve që u nda në tre lote edhe te Metamorfoza

A FLASIN BANDAT PËR POLITIKË NË PËRQJIME?



janë të njëjtët njerëz që vrasin, bëjnë biznes dhe kontribuojnë për vota në zgjedhje. Krim, biznes, politike - ky është trekendeshi i Bermudes ku nuk janë zhytur vetëm 50 të akuzuarit.

Politika për krimin është si oksigjeni. Sa më shpejt të priten tubat e furnizimit aq më mirë për të gjithë. Varianti që ata nuk kanë folur në "Sky" për politikë ka pak gjasa të jetë i vërtetë se përndryshe na del që bandat i paskemi patur të depolitizuara. Emrat aty nuk të lënë asnjë pikëpyetje. Pyetja është pse janë veçuar rrefimet për "politikën"?

VENDIMET E GJYKATËS SI LETRA QË S'THUHET

Dy raste flagrante! Parlamenti shpërfill vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Komisioni Pavarur i Kualifikimit nuk zbaton vendimin e Gjykatës Apelit administrativ për të bërë transparent emrin e një sponsori të një aktiviteti!

E pamendueshme! Njerëzit që votojnë faturat e prokurorëve dhe gjyqtarëve edhe të vitit 1991 jo vetëm nuk zbatojnë ligjin 119/2014 për te drejtën e informimit, por kanë guxim të mos zbatojnë vendimin e gjykatës!? Dhe gjykatës se reformuar prej tyre!

Çfarë ndodh kur nuk zbatohen vendimet e gjykatave? Themelet e sistemit juridik hidhen në erë dhe besimi publikut te gjykata kthehet në shaka.

1. Minohet sundimi ligjit

Moszbatimi i vendimeve gjyqësore dobëson sundimin e ligjit, pasi u lejon individëve, subjekteve, apo institucioneve të shpërfillin vendimet pa e vrarë mendjen. Për pasojë rritet paligjshmëria dhe mosndëshkimi. Kushdo bëhet "trim" duke shpërfillur ligjin. Dhe vjen dita dhe hapim gojën me guxim që kanë për të grabitur prona dhe fonde publike.

2. Humbja e besimit tek gjyqësori: Kur vendimet e gjykatës nuk respektohen, besimi publikut te gjykata shkon në zero.

3. Rritja e mosmarrëveshjeve dhe konflikteve: Vendimet e gjykatës që mbesin në letër shtojnë mosmarrëveshjet mes palëve në konflikt. Kjo situatë sjell

konflikte të mëtejshme, juridike dhe sociale, pasi palët e dëmtuara i drejtohen mjeteve alternative për të zgjidhur hallin. Dhe pyesim pse janë rritur aktet e vetëgjyqësisë dhe referencat në Kanun.

4. Demokracia si farsë
Respektimi i vendimeve gjyqësore është thelbësor për ruajtjen e ndarjes së pushteteve dhe sigurimin e kontroleve dhe ekuilibrave brenda një sistemi demokratik. Kur vendimet e gjykatave shpërfillen, minohet parimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe demokracia kthehet në parodi.

5. Ndikimet në investime dhe stabilitet ekonomik:

Zbatimi sipas dëshirës i vendimeve gjyqësore shkurajon investimet vendase dhe të huaja. Kush do të punojë dhe jetojë në një vend ku nuk sundon ligji?

Kur nuk zbatohen vendimet e gjykatës nuk ka më kuptim të flitet për shtet të drejtës, por për xhungel.

Qershia mbi torte një tjetër ngjarje në polici: Nje oficer policie fiton gjyqin në të dy shkallët e gjyqësorit për njohje e grades në bazë të karrieres. Me vendimin e gjykatës në dorë shkon te (ish) drejtori i përgjithshëm i policisë i cili pasi lexon vendimin në konfidencë i thotë: Kke të drejtë, por kam vendosur të mos zbatoj asnjë vendim gjykatash për gradat?

Çfarë të thuash? Mbetet të pyesim nëse ligjet janë për t'u zbatuar apo janë thjesht çështje interpretimi?



NA GJENI NA FACEBOOK
KERKO THE ALBANIAN
MBI 1 000 000 NDJEKES

POROSISNI BANNERIN PËR BIZNESIN TUAJ

- Business Cards
- Logo
- Flyers
- Video Marketing

Na kontaktoni: **020 7018 7929**

Dottech
website

MICHAEL MARTENS

Politika e jashtme gjermane është e klasit botëror kur bëhet fjalë për t'u marrë me të kaluarën. Vetëm kur bëhet fjalë për të përballuar të tashmen dhe të ardhmen, ajo çalon. Merrni për shembull Ballkanin. Gjermania luajti një rol qendror në caktimin e një dite përkujtimi për gjenocidin e Srebrenicës, e cila u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së të enjten. Nuk ka asgjë të keqe me përkujtimin e krimit të madh serb në Bosnje në vitin 1995. Më e rëndësishme për stabilitetin e rajonit, megjithatë, do të kishte qenë mbështetja e Gjermanisë për aplikimin e Kosovës për t'u anëtarësuar në Këshillin e Evropës, e cila gjithashtu duhej të ishte votuar në maj.

Anëtarësimi i Kosovës në Këshillin e Evropës do të kishte nënkuptuar që të gjithë qytetarët e demokracisë më të re evropiane, duke përfshirë edhe pakicën serbe, do të kishin mundësi ta padisnin qeverinë e tyre para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Mbi të gjitha, do të kishte qenë një sinjal tronditës për Serbinë dhe presidentin e saj Aleksandar Vuçiq, i cili flirtonte me afërsinë e vazhdueshme me Rusinë dhe Kinën. Vuçiq flet hapur për luftë, duke e quajtur shembullor sulmin e Azerbajxhanit ndaj Karabakut. Nëse nuk i vendosen kufij, ai do të vazhdojë të punojë për t'i shtyrë ata, qoftë edhe me forcë.

Pranimi i Kosovës në Këshillin e Evropës do të ishte një shenjë se Europa nuk toleron zgjidhje të dhunshme politike në Ballkan. Por ky sinjal nuk u dha, pjesërisht sepse Berlini ishte një nga shtetet që e pengoi atë. Edhe pse të gjitha organet përkatëse të Këshillit të Evropës dhe shumica dërrmuese e Asamblesë Parlamentare të tij besojnë se Kosova i ka përmbushur të gjitha kushtet për t'u pranuar në klubin më të vjetër të demokracive evropiane, Berlini u shpreh kundër. Fakti që Hungaria dhe Rusia mbajnë të njëjtën linjë në këtë çështje do të thotë shumë.

Gabimi i një politike ballkanike serbocentrike nuk është i ri. Një

BERLINI GABOI ME KOSOVËN, BASTI I HUMBUR I MBËSHTETJES TEK SERBIA



brez më parë, politika perëndimore në Ballkan bëri të njëjtat gabime. Në atë kohë, ajo mbështetej te Slobodan Millosheviqi (i cili më vonë u padit nga Gjykata për Krimet e Luftës) si një spirancë stabiliteti; sot e sheh ish-ministrin e tij të propagandës Vuçiq në këtë rol.

Në vitet 1990, luftërat me më shumë se 100 mijë të vdekur dhe miliona persona të zhvendosur, si dhe masakrat si ajo në Srebrenicë ishin rezultat i këtij gabimi tragjik. Tani po shfaqet edhe një herë besimi i gabuar se gjithçka që nevojitet për të arritur paqen në rajon është të qetësohet Beogradi. Nuk është bindës as argumenti se Serbia duhet të furnizojë me municion Ukrainën. Serbia dëshiron të shesë prodhimin e fabrikave të saj të armatimit dhe po bën

biznes të mirë me to. Pavarësisht gjithë rusofilisë së tij, Beogradi nuk dëshiron që kjo ta ndërpresë këtë burim.

Por nuk është vetëm faji i Berlinit që Perëndimi ka pak ndikim në Ballkan. Ajo që dikur ishte instrumenti më i rëndësishëm i ndikimit perëndimor, perspektiva e anëtarësimit në BE, nuk ekziston më. Kur perspektiva e anëtarësimit ishte ende realiste, ajo solli energji të konsiderueshme reformash. Radovan Karaxhiç dhe Ratko Mlladiç, dy personat më përgjegjës për Srebrenicën, nuk do të ishin arrestuar dhe dorëzuar në gjykatën e krimeve të luftës respektivisht në vitin 2008 dhe 2011 nëse perspektiva e anëtarësimit në BE nuk do të dukej realiste në atë kohë.

Megjithatë, pothuajse asnjë politikan në rajon nuk është tani i gatshëm të investojë kapital politik në reforma thelbësore. Me përjashtim të qeverisë së re malazeze, drejtuesit e së cilës janë ende të rinj dhe pa përvojë, asnjë politikan kryesor në Ballkanin Perëndimor nuk beson me të drejtë se vendi i tij mund të pranohet në BE. Prandaj është e kuptueshme që Hristijan Mickoski, kryeministri i ardhshëm i Maqedonisë së Veriut, nuk është i përgatitur për të përmbushur parakushtet e Bullgarisë të mbështetura nga BE për fillimin e bisedimeve të anëtarësimit. Maqedonia e Veriut madje kishte ndryshuar emrin e saj shtetëror për hir të perspektivës evropiane, por më pas u bllokua fillimisht nga Franca dhe më pas nga Bullgaria.

Sofja po kërkon që Maqedonia e Veriut së pari duhet të përfshijë pakicën bullgare në vendin e saj si një komb përbërës në preambulën e kushtetutës përpara se të fillojë bisedimet e pranimit. Ka një arsye të mirë për të qenë skeptik në Shkup, pasi Bullgaria kishte hartuar ndërkohë një listë të kërkesave të mëtejshme, në disa raste historikisht groteske, për vendin fqinj në vitin 2019. Nëse Maqedonia e Veriut dorëzohet tani, kjo do të hapte vetëm derën për një kaskadë të ultimatumëve të mëtejshme. Prandaj, qeveria e ardhshme në Shkup mund të inkurajohet që të mos e ndjekë këtë qorrsohak.

©Nga Michael Martens, marrë nga Frankfurter Allgemeine Zeitung, përshtati në shqip LAPSI.al

KURTI: ARMATIMI I SERBISË SHPËRFAQ RREZIKUN E DESTABILIZIMIT TË RAJONIT

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, gjatë fjalimit të tij në Konferencën e Mbrojtjes që po mbahet në Londër, ka pralajmëruar rrezikun e destabilizimit të Ballkanit Perëndimor nga ndikimi serb dhe rus.

Zyra e kryeministrit të Kosovës njofton se kryeministri Kurti ka thënë se ky rrezik vjen nga zyrtarët e lartë të Serbisë, të cilët kanë qenë pjesë e regjimit të Millosheviqit në fund të viteve '90, ndërsa sot janë aleatë të Rusisë dhe Kinës.

“Ndërkohë që Ballkani Perëndimor dhe rajoni në përgjithësi është zhvilluar me shpejtësi të madhe dhe ka ndryshuar në mënyrë domethënëse, kërcënimet kanë vazhduar të jenë të pranishme, dhe kjo jo pak për faktin që zyrtarë të lartë të regjimit të Millosheviqit që ishin në pushtet një çerek shekulli më parë edhe sot janë në pushtet në Serbi, përfshirë këtu presidentin aktual të Serbisë, por edhe për faktin se Serbia po krijon gjithnjë e më shumë lidhje të ngushta me Rusinë dhe Kinën”, citohet të ketë thënë Kurti.

Kurti ka thënë se armatimi i Serbisë shpërfaq aspiratat territoriale të saj.

“Lidhja e saj me Rusinë, qasja e saj shkatërruese ndaj Republikës sonë dhe armatimi i saj i shpejtë dhe i



madh janë tregues se ajo synon përshtetëzimin me synimin për të realizuar ambicidet e saj territoriale. Tri nga katër brigadat e kombinuara të ushtrisë së Serbisë, duke përfshirë 48 bazat operative përpara rreth kufirit të Kosovës, pa përfshirë njësitë tjera të specializuara, janë të stacionuara në territorin jugor, afër kufirit me Republikën e Kosovës. Kërcënimet nuk është

thjesht teorik. Rreziku i një lufte të re është real”, ka thënë ai.

Kurti ka folur për rolin kritik të NATO-s dhe të vendeve aleate në çlirimin e Kosovës 25 vjet më parë, dhe për rrezikun që paraqesin sot autoritetet për sigurinë në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor.

Ai ka folur për sulmin terrorist të grupit paramilitar serb në Banjskë, për incidentet dhe provokimet tjera në pjesën veriore të Kosovës. Ai theksoi se këto janë pasojë e tolerancës ndaj kërcënimeve të hapura të Serbisë ndaj sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës.


Kurti ka tërhequr vërejtjen edhe për

rrezikun që paraqet infrastruktura dezinformuese ruse për rolin e NATO-s dhe të Perëndimit në Ballkanin Perëndimor. Ai ka thënë se sot në rajon është nevojshëm kohezioni dhe aleanca e vendeve demokratike që para 25 vjetësh i dha fund konflikteve të përgjakshme në hapësirën e ish-Jugosllavisë.

“Sot është e nevojshme të ripërtërihet kohezioni dhe aleanca demokratike e para 25 vjetëve, në mënyrë që shtetet që mbrojnë vlerat demokratike, të mbyllin boshllëkun politik dhe praktik që i bën liderët autoritarë të besojnë se sulmi ndaj një vendi tjetër evropian, apo çfarë do sulmi, është i mundshëm”, ka theksuar ai.

Kurti ka kujtuar se ndërhyrja e NATO-s në vitin 1999 e ka ndaluar gjenocidin e Serbisë së Millosheviqit ndaj shqiptarëve në Kosovë, çlirimin e Kosovës dhe krijimin e shtetit demokratik të Kosovës.

“25 vjet pas intervenimit të NATO-s, Kosova është forcuar me ndihmën e aleatëve ndërkombëtar dhe tani është demokracia numër një në rajon, krahas përparimit ekonomik e shoqëror”, ka thënë ai.



Skano

**NA GJENI
NA FACEBOOK
KERKO
The Albanian
MBI 1 000 000
NDJEKES**

Akoma nuk keni një website?

MUND TE VINI NË ÇDO KOHE NË ZYRAT TONA

Akoma nuk jeni regjistruar në Google?

- ✓ BUSINESS CARDS
- ✓ BANNERS
- ✓ LOGO
- ✓ POSTERS
- ✓ VIDEO MARKETING

The Albanian

OFERTA
SPECIALE

Dotech
websites 

KONTAKTONI

ADRESA E ZYRAVE:
30 AVENONS ROAD
LONDON, E13 8HT

020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545



VETON SURROI

SERBIA MES TITOS DHE ENVER HOXHËS?

Tito e Enver Hoxha, në mënyra të ndryshme dhe me ca vonesa (në rastin e Shqipërisë) u angazhuan që Rusia të mos hyjë në shtetet e tyre, apo që shtetet e tyre të mos angazhohen për interesat e Rosisë. Kjo nuk mund të thuhet si përfundim për politikën e Serbisë së sotme dhe paraqet dilemën parësore: kurdo të tërhiqet vija e armëpushimit Ukrainë-Rusi a do të jetë Ballkani Perëndimor një zonë unike e sigurisë?

1.

Ndodh ritualisht e shpesh në publicistikën serbe, posaçërisht të asaj në opozitë, që Serbia, gjegjësisht prijësi i saj, Aleksandar Vuçiç, të krahasohen, e herë edhe të barazohen me Enver Hoxhën. Në interpretimin e këtyre krahasimeve, Serbia po përpriqet të mbajë balancë mes Lindjes dhe Perëndimit sikur Titoja. Për më tepër, pjesë e kësaj balance është edhe mbajtja e lidhjeve mes vendeve të Botës së Tretë që ishin boshti i Lëvizjes së të painkuadruarve, njëri prej themeluesve të së cilës ishte Titoja. Dhe, në interpretimin krahasues, Serbia po lidhet me Kinën, ashtu siç bëri Enver Hoxha në kohën e vet.

Nënteksti i këtyre interpretimeve është se Serbia po humb kohë, se duhet të orientohet kah Perëndimi, gjegjësisht BE-ja dhe NATO. Argumenti thotë se po ta kishin bërë këtë Titoja dhe Enver Hoxha me kohë, për shembull kur Bashkimi Sovjetik hyri në Çekosllovakia më 1968, vendet e tyre do të ishin në gjendje më të mirë, tashmë do të ishin pjesë e botës transatlantike.

Por, ashtu siç nuk ka histori me “po të kishte ndodhur në këtë formë, rezultati do të ishte i këtille”, ashtu nuk ka edhe përshkrim krahasues pa kontekst paraprak. Po, është e vërtetë se Serbia ka ngjashmëri me Titon dhe Enver Hoxhën për sa i përket mospërcaktimit për identitetin perëndimor të shtetit (dhe kjo është pjesë e ideologjisë së “veçantizmit” të cilën po e ndërton prej kohës së Milosheviçit). Por, jo, Serbia nuk ka kapacitet, nuk ka ndërmend dhe nuk do ta themelojë e as t’i prijë Lëvizjes së të painkuadruarve mes Lindjes e Perëndimit. Dhe jo, Serbia nuk synon të lidhet me Kinën si partner të vetin të vetëm strategjik në një luftë ideologjike kundër tërë botës.

2.

Ç’është e vërteta, lëvizjet e Serbisë kanë marrë fillimisht diçka prej Titos, atë të balancës mes superfuqive. Por, dallimi është thelbësor: Tito prej vitit 1948 që dëbuar prej kampit sovjetik (partive komuniste rreth Moskës, Paktit të Varshavës) dhe iu kthye Perëndimit për ndihmë në armë e përkrahje financiare si mundësi të mbijetesës. Lindjes i tha se vazhdon të jetë komunist, Perëndimit i tha se



është komunist, por i një specieje të veçantë që nuk merr urdhra nga Moska. Evropianëve u tha atë që ishte e vërtetë, se ishte evropian. Botës së tretë i tha atë që ishte e vërtetë, se ishte Botë e Tretë.

Ndërsa Jugosllavia iu kthye Perëndimit ngase u dëbua nga Lindja, Serbia nuk u dëbua nga Perëndimi. Në fakt vendet e NATO-s prej kohësh janë shprehur për bashkëpunim të ngushtë me Serbinë e BE-ja ka hapur negociatën për anëtarësim. Pra, kthesa e Serbisë kah Lindja u bë për arsye krejtësisht të kundërta; në interpretimin e Serbisë, kthesa kah Lindja nuk është bërë pse Perëndimi nuk e dëshiron Serbinë, por sepse këtë duhet ta dëshmojë, pra duhet të tregojë se e do Serbinë brenda BE-së aq shumë sa që këtë ta dëshmojë me vendime të përkrahjes financiare, politike dhe çfarëdo tjetër për anëtarësim të shpejtë në të. Kur pastaj në këtë ekuacion hyn Kosova, gjërat shkojnë kah një cikli vicioz të mëtejme. Sepse, përderisa Kosova të jetë pengesa më e madhe e objektivave për Serbinë evropiane, një pengesë që kjo Serbi si ajo e mëparmja nuk ka ndërmend ta zgjidhë nëpërmjet normalizimit të marrëdhënieve të ndërsjellta, lidhja e Serbisë me Lindjen është një sinjal i Perëndimit që duhet të bëjë edhe më shumë për të në mënyrë që të mos anojë më shumë kah Lindja.

Kjo lojë e balancës, ku Perëndimi duhet të dëshmojë se sa e do Serbinë brenda vetes, deri më tani ka funksionuar. Dhe, për dallim prej kohës së Titos, ku Perëndimi vetëm kishte nevojë të dëshmojë se sa nuk do që Jugosllavia të kalojë në kampin sovjetik, tash steka për të është ngritur

edhe për një shkallë, duhet të dëshmojë se sa me të vërtetë do të Serbia të kalojë në Perëndim, të hyjë në BE.

Serbisë, për ngritje të stekës i ka ndihmuar gjeopolitika, gjegjësisht leximi i kujdesshëm i saj. Rregullat e Luftës së Ftohtë që i ndihmuar Titos për të mbajtur balancën nuk vlejnë më; shkoi Titoja e pas tij edhe Lufta e Ftohtë. Pas një periudhe të akomodimit me rënien e Murit të Berlinit tash jemi në një rikompozim të marrëdhënieve ndërkombëtare. Marrëdhëniet që do të dalin, mes të tjerash, prej fundit të luftës në Ukrainë, rikompozimit të Lindjes së Mesme me rol të ri të Arabisë Saudite, pozicionit të Iranit dhe balancës së përgjithshme SHBA-Kinë, do të vendosin natyrën e fërkimeve mes botës transatlantike dhe asaj euroaziatike. Serbia është duke shikuar këtë teatër gjeostrategjik, jo atë të Titos e Enver Hoxhës.

3.

Procesi i ndryshimit gjeopolitik nuk ka treguar ende konturat e marrëdhënieve të reja. Dhe, ndonëse ky proces nuk ka përfunduar është e qartë se krahasimi i Serbisë së tanishme me Enver Hoxhën është fare i pavend dhe më shumë dëshirë asociimi negativ për figurën e Vuçiçit. Ndërsa Enver Hoxha u lidh me Kinën për të ikur nga Bashkimi Sovjetik (dhe Perëndimi), Serbia po lidhet me Kinën si me ekonominë e dytë më të fortë në botë e duke e shndërruar veten në treg konkurrence teknologjike, financash, tregtie ndërkombëtare dhe, përfundimisht, një Bote euroaziatike që fillon dikund në linjën e frontit mes forcave ukrainase dhe ruse në terri-

torin e Ukrainës dhe përfundon në Vladivostok e Kinë. Kjo botë mund lehtë të përfshijë në politika ekonomike Indinë e Afrikën e Jugut e në politikë të sigurisë edhe Korenë veriore e Iranin dhe ndonjë kandidat eventual që beson në këso renditje botërore që ndërtohet mbi rregullin se nuk ka rregulla të vjetra. Enver Hoxha që lidhur me Kinën e izoluar për ta izoluar Shqipërinë sa më shumë brenda asaj Kine. Serbia po lidhet me Kinën si fuqi botërore për ta integruar edhe më shumë në atë që nesër do të jetë bota euro-aziatike, BRICS apo Jugu global, por duke mos e ndërruar adresën e vendbanimit në kontinentin evropian.

Në një analogji të largët leximi gjeopolitik i presidentit Vuçiç mund të jetë i ngjashëm me atë të Titos. Pra që Perëndimit t’i thotë se Serbia e ka të përcaktuar rrugën evropiane, Rosisë se ka një politikë të pavarur dhe neutrale që nuk e pengon lidhje të ngushtë me të, Kinës se kërkon partneritet strategjik në financa, investime, tregti, inteligjencë artificiale; Botë së tretë t’i thotë se edhe Serbia ndihet pjesë e atij Jugu global.

Ky lexim deri më tani ka funksionuar. Serbia ka testuar seriozitetin e BE-së dhe NATO-s ndaj Ballkanit Perëndimor prej momentit kur është anëtarësuar Kroacia, pra prej vitit 2013. I ka rezultuar se ka progres më të madh drejt Bashkimit Evropian kur Bashkimi Evropian është më i interesuar për ta pasur Serbinë brenda sesa vetë Serbia. Si në transfertë klubesh futbollit, gjetje të vendit të punës apo shitjes së kompanisë rëndom ndodh të kesh më shumë rezultat kur të kërkojnë sesa kur e ofron veten.

4.

Tito dhe Enver Hoxha nuk panë përfundimin e pozicionimeve të tyre gjeopolitike ngase konteksti ndryshoi pas vdekjes së tyre.

Gjendjen e tanishme të tranzicionit drejt konturave të një rirrenditjeje globale mund ta testojë Serbia e sotme kurdo të arrijë momenti i të kuptuarit se lufta në Ukrainë nuk ka fitues ushtarak dhe se do të krijohet një vijë e re armëpushimi, paqëje të përkohshme apo çfarëdo emri të ketë mes forcave ukrainase dhe atyre ruse e në bazë të një Marrëveshjeje. Në atë moment, mund të tërhiqet vija e përkohshmërisë (pak më të gjatë) mes botës transatlantike e euro-aziatike në atë pjesë të globit.

Për Evropën, Serbinë dhe fqinjët e saj mund të paraqiten disa skenarë. Në politikën dëshirore evropiane skenari i prituri është ai moment kur Evropa merr përgjegjësinë historike, “zeitenwende”, të kthimit të madh dhe krijon një zonë të lirisë, sigurisë dhe përkatësisë brenda BE-së në një periudhë rekord që nisat prej prioritetit gjeopolitik para çdo gjëje tjetër.

Për politikën dëshirore të Serbisë mund të paraqitet momenti kur mbajtja e “pavarësisë dhe neutralitetit” në politikën karshi Rosisë është çasti i eksklamimit “a ju kemi thënë” që Rusia nuk mposhtet me luftë; do të harrohet presioni për njësimin e politikës së Jashtme evropiane karshi Rosisë.

Por, në real-politikë mund të paraqiten dy skenarë negativë për Evropën, Serbinë dhe fqinjët e saj.

I pari do të ishte nëse vija ndarëse mes botës atlantike dhe euro-aziatike të kalonte mepër territorin e popullit serb me një pjesë të rëndësishme të popullatës me besim në botën euroaziatike; i tërë ideologjizim i përditshëm mediatic mbi lidhmërinë e veçantë të Serbisë me Rusinë tashmë është shndërruar në besim kolektiv për një pjesë të popullatës.

Skenari i dytë do të ishte po që se kjo vijë ndarëse replikohet edhe gjithandej Ballkanit perëndimor, me skenarin më të padëshiruar të mundshëm mes të tjerash edhe në vijën kufitare mes Kosovës dhe Serbisë.

Tito e Enver Hoxha, në mënyra të ndryshme dhe me ca vonesa (në rastin e Shqipërisë) u angazhuan që Rusia të mos hyjë në shtetet e tyre, apo që shtetet e tyre të mos angazhohen për interesat e Rosisë. Kjo nuk mund të thuhet si përfundim për politikën e Serbisë së sotme dhe paraqet dilemën parësore: kurdo të tërhiqet vija e armëpushimit Ukrainë-Rusi a do të jetë Ballkani Perëndimor një zonë unike e sigurisë?



For Sale

FOR SALE

**ÇMIMI SHUMË I ARSYESHËM
MUNDESI FANTASTIKE
PER ZHVILLIMIN E BIZNESIT**



**SHITET NJE RESTORANT I RINOVUAR
NE NJE NGA ZONAT ME TE FREKUENTUARA TE LONDRES
TE ARDHURA TE LARTA
I PAJISUR ME TË GJITHA LIÇENCAT**



For Sale



For Sale



For Sale



WHATSAP: 07956030065

TEL: 07956030065

NDUE DEDAJ

Ka kombe që e kanë kaluar rilindjen e tyre, por ne shqiptarët jo. Se përndryshe postulatet atdhetare e poetike të Rilindjes nuk do të ishin kaq aktuale. Mund të qëmtojmë vargje sa të duam nga letërsia e njëqind e ca viteve më parë, por po shkëpusim vetëm katër të tilla nga poezia “Gjuha shqipe” të Gjergj Fishtës:


“edhe shqyp na thanë se Zoti për shqyptarë Shqypninë e fali, se sa t’enden stina e moti, do ta gzojn kta djalë mbas djali”.

Por, a po e gëzojnë shqiptarët Shqipërinë, djali mbas djali e kohë mbas kohe? Shqiptarët po “gëzojnë” vendet e tjera të rruzullit, por jo atdheun e tyre, pasi atë e kanë uzurpuar hajnat e shtetit, të papërgjegjshmit e gubernës, njerëzit e kotësisë dhe të kriminit. Nuk flitet më për ideale e idealizëm, atdhedashuri, por për atdhezvatje. Është e frikshme të thuash këtë, por realiteti ky është. Dosjet e SPAK dhe kolonat e gazetave mbushën përditë me bisedat kriminale të përgjimeve, për hakmarrje të shqiptarëve ndaj shqiptarëve. Kryeministri na thotë se drejtësia është arritja më e madhe që nga viti 1912 e këndeje. Sigurisht kjo është e vërtetë për në Europë e Amerikë, ku ligji nuk kursen as kryeministrat e presidentët, le pastaj McGonigal-ët, por ende jo në vendin tonë. Shqipëria po na rrëshqet nga duart dhe nga sytë. Prandaj do të donim që jo vetëm mësuesit dhe profesorët e letërsisë në shkolla e auditorë universitare, por edhe vetë kreu i shtetit, qeveritarët, drejtuesit e tjerë ta nisnin ditën duke shqiptuar fort këto vargje të Fishtës, poemat e De Radës, Naimit etj. dhe në radhë të parë, Himnin e Flamurit. Me të drejtë një poete kishte përzgjedhur katër vargje të rilindasit Prend Doçi për të fshikulluar marrëzinë e fundit në tarracën e Bashkisë së Tiranës, ku u “çiftëzuan” në martesë dy gra fatkeqe:

“Erz ma s’kemi, na marruen Varza e gra kan shkue n’robni Të tan vllazënt na i faruen, Kush mbet nesh, mbet faqezi...”

2-Bash për këtë bjerrje të përgjithshme të vlerave kombëtare e morale na duhet një rilindje e dytë. Për të ruajtur identitetin shqiptar, siç kishte qenë dhe qëllimi i Rilindjes Kombëtare të 900-ës. Atëherë identiteti kërcënohej nga sundimi i gjatë otoman, copëtimi i kufijve ndër fqinjë etj., kurse sot nga të tjerë faktorë. Shqiptarët, në vend që të përbashkoheshin në kohë moderne, po i braktisin përditë e më shumë trojet e tyre amtare, çka e bën të domosdoshme një “Bibël” të tyre përreth mëmëdheut. Nëse udhëheqësit e Shqipërisë, por edhe të Kosovës, në demokraci herë-herë kanë pasur qasje “sulltanore” ndaj të qeverisurve të vet, si dhe servilizëm apo karshillëk ndaj ndërkombëtarëve, sa i përket gjeopolitikës rajonale, ka pasur ngjarje që mund të quhen të jashtëza-

A ËSHTË KOHA E NJË RILINDJEJE TË DYTË KOMBËTARE?



konshme, ku në tri vitet e fundit kemi dy kryeministra shqiptarë, Dritan Abazović në Mal të Zi dhe Telat Xhaferi në Maqedoninë e Veriut, ky i fundit më parë kryetar i Kuvendit.

Kemi deputetë shqiptarë të Preshevës në Parlamentin e Serbisë. Pesë vite më parë shqiptarja Arba Kokalari (Suedi) u bë deputete e Parlamentit Europian. Kjo është një meritë që duhet t’ia njohim politikës. Ashtu siç është pazotësia e saj që zëri shqiptar, tekta rritet në Europë, po meket (mpaket) në trojet e veta. Është një kontradiktë, që mund ta zgjidhë vetëm një rilindje e dytë kombëtare, pas njëqind e pesëdhjetë vjetësh nga fillimet e së parës. E nëse Rilindja e parë i kishte vatrat jo pak jashtë vendit, kjo e dytë lipset t’i ketë pikë së pari brenda trojeve.

Arbëreshët, edhe pse përherë e më të paktë, vijnë përherë e më shumë këndeje Adriatikut. Ka filluar të vijë dhe diaspora në ditë festive kombëtare, shkojnë dhe qeveritarët për t’i takuar emigrantët. Atje vihen buste të Skënderbeut dhe hapen shkolla shqipe, bëhen mbrëmje për 28 Nëntor dhe i këndohet atdheut me dashuri, pa kurrfarë pompoziteti, grimasash dhe “aktrimi” patriotik, siç ndodh shpesh këndeje për të fituar zemrat e vorfnuara të votuesve. Rilindja, për të cilën po flasim, do ta bënte këtë klasë politike të rrjedhur e të tredhur t’ia linte vendin një elite të re. Teksa Kosova, edhe prej rrethanave të krijuara, qarkullimin e elitave politike e ka realizuar.

Gjithë çfarë (s’)është bërë në këto tridhjetë vjet nuk kanë mjaftuar që shqiptarët të jenë një zë në Europë, edhe pa qenë një shtet. Vetëm me këtë shpjegohet fakti që Shqipërisë i ofrohet, por nuk i jepet anëtarësimi në BE, sikur në këtë forum nuk do të hyjnë shqiptarët, por qeveritarët e korrupuar. Po ashtu, kurrfarë drejtësie nuk ka nga ana e politikës dhe diplomacisë europiane, që Kosovës i ofrohet në prill, por nuk i jepet në maj,

anëtarësimi në Këshillin e Europës. Po ashtu, si mundet që një vend i BE si Greqia bën politikë provinciale, duke kandiduar për në Parlamentin Europian një të dënuar për manipulim zgjedhës të një vendi tjetër!? Kjo do të thotë se të ashtuquajturat murana të Ballkanit nuk bien dhe aty ku besohet se demokracia është e konsoliduar. Por, edhe disa zhvillime përtej gadishullit, shpesh nuk janë të duhurat për shqiptarët. Vite më parë Shqipërisë i kërkohet të bëhej vendi i shkatërrimit të armëve kimike, tani që të bëhet strehë për refugjatët afrikanë të Italisë, duke vënë në dispozicion Shëngjinit dhe Gjadrin.

Sigurisht që të gjitha këto duan përgjigje politike nga ana e shqiptarëve, por të atilla që të ishin në frymën e një rilindjeje moderne dhe jo të “rilindjes” qeverisëse, që mendon se mjeti më i mirë për të ndenjur pushtet është oratoria kryeministore para emigrantëve në një stadium të Greqisë. Çfarë kuptimi ku turi i Kryeministrit në Athinë, Milano, Londër, Dyseldorf për t’u takuar me emigrantët shqiptarë kur atyre nuk mundësohet votimi në atdhe? Nga ana tjetër është hipokrizi të shtiresh i dashur me njerëzit e thjeshtë me flamuj në duar dhe të mos ngrihesh në këmbë për t’i dhënë dorën homologut tënd të Kosovës, por të sillësh me të si “sheff” i tij!? Të mbahesh me të madh, edhe pse nuk të ecën puna, kjo është pririje e sundimtarëve. Vetëmburremi me arritje të qena e të paqena, kurse ata jashtë na thonë se nuk i keni punët mirë. Vërejtje nga BE në tërësi për mosbërjen e “detyrave të shtëpisë”, plotësimin e rekomandimeve, kryerjen e reformave, keqpërdorimin e grandeve për bujqësinë, vlerësimet negative të Piza-s për arsimin, kritikën e “Reporterëve pa Kufi” për lirinë e medias etj.. Pas këtyre, a kanë kuptim batutat ‘ne s’jemi më të mirët, por më të mirë se ne nuk ka’!? Po, po, gjithmonë ka më të mirë se shpërdoruesit e pushtetit.

3-Nuk janë vetëm problematikat e rëndësishme në rrafshin gjeopolitik e gjeostrategjik, por dhe përditshmëritë e “vogla”, të “padukshme”, tronditëse kur i analizon. Po ndalemi në një dukuri, sa të vjetër, aq dhe të re. Martesat mes njerëzve të kombësive të ndryshme, në vend që të jenë dashuri, lumturi, diversitet kulturor e gjuhësor, shpesh kanë qenë e kundërta, bjerrje e vlerave të shqiptarisë. Bisedonim kohë më parë me një grua në një kryeqytet të rajonit. Ajo ishte nga një fshat i Shqipërisë së Mesme, martuar në një burrë të një kombësie tjetër në një shtet fqinj. Me mblesëri të kohëve moderne. Kishin bërë si kishin bërë për t’u marrë vesh me njëri-tjetrin, por nuk do të merreshin vesh që fëmijët të mësonin dhe gjuhën e nënës. Asnjëri nga katër fëmijët, tri vajza dhe një djalë. I shoqi nuk kishte dashur, me argumentin se fëmijët do të ngatërroheshin e nuk do të mësonin dot gjuhën e etnisë të cilës i përkisnin nga i ati. Dhe ky është vetëm një brez, i njëzet e pesë vjetëve të fundit. Të jetë ky globalizmi? Apo kjo është më së pari një dukuri ballkanike e asimilimit shqiptar, përfshi dhe familjen. Doemos që nuk do të ndalohen martesat e kombësive të ndryshme, por e drejta e gjuhës duhet të njihet me ligj. Dihet dhuna ndaj gruas në Ballkan në forma të ndryshme, fizike, psikologjike etj., por dhuna ndaj gjuhës është e paimagjinueshme. “Fëmija yt si grua nuk do të flasë shqip, për shkak se është fëmija im, që jam burrë serb, malazez, boshnjak, maqedonas, grek etj..” Na rroftë që i tubojmë bashkëkombësit rreth përmendoreve të Skënderbeut në Tiranë, Prishtinë, Dibër të Madhe, Shkup e Ulqin, kur fëmijët e etnisë sonë nuk dinë gjuhën e tyre!...

Rilindja e parë në të vërtetë u pasua nga një e dytë, paçka se nuk pati ndonjë emërtim të tillë, në vitet e Luftës së Dytë Botërore, kur në Kosovë dhe troje të tjera shqiptare jashtë kufijve të 1913-ës u hapën shkollat shqipe dhe u vendos admin-

istrata e shtetit shqiptar, ndonëse nën pushtim, që u udhëhoq nga rilindas si Mustafa Kruja e Ernest Koliqi, çka individualisht ishte bërë dhe më parë nga rilindas si Shtjefën Gjeçovi etj.. Por, ky projekt kombëtar përëndimor mbeti pa u përfunduar, për shkak të krijimit të federatës komuniste jugosllave të pas Luftës së Dytë Botërore. Autonomia e Kosovës së vitit 1968 është një përpjekje, sërish nën pushtim, për të botuar libra shqip, hapur universitet shqiptar, shkëmbime kulturore mes Shqipërisë dhe Kosovës etj..

Por, gjithsesi, rilindja shqiptare në këtë periudhë historike nuk ndodhi, pasi shqiptarët nuk kishin shtetin e tyre, siç e kanë sot në Kosovë, apo ku janë në pushtet në vendet e tjera dhe gjuha shqipe është gjuhë e dytë zyrtare. Shqiptarët në Kosovë, Shkup apo Tetovë, në këto tridhjetë vjet krijuan liderët e vet shpirtërorë dhe politikë, si Ibrahim Rugova, Ukshin Hoti, Anton Çeta, Dritan Abazović, Arbër Xhaferi etj. dhe kjo nuk është pak. Rilindjen e sjellin njerëzit me shpirt rilindës, ringjallës. Shqiptarët e kanë vetëdijen kombëtare, por tash është koha për ta ridëshmuar edhe njëherë, me qëllim që vonesa e integritimit evropian, shpopullimi masiv i trojeve shqiptare, apo dhe globalizmi “përmbytës” i vlerave lokale të mos na shndërrohet në një krizë ekzistenciale! Pa lënë mënjatë asnjë çast strategjinë shkombëtarizuese serbe ndaj shqiptarëve në Mitrovicën veriore etj.

Shqiptarët kanë elitën e vet filozofike, letrare, shkencore, kulturore, politike, por nuk dimë sa ajo është dhe akademike, në kuptimin sa mendimi shqiptar zë vend në agjendat e akademive të shkencave etj.. Shoqëritë, atdhetarë kulturorë të Rilindjes Kombëtare u quajtën akademi, pasi u përpoqën të luanin një rol ndriçues ndër shqiptarë. Roli “ndriçues” është dhe sot dhe fanarët janë, por ai i shohim ata. Përballë krekosjes së qeveritarëve janë artistët e mëdhenj, ta pabujshëm të kombit. Vetëm pak ditë më parë sopranoja e shquar Ermonela Jaho u vlerësua nga Mbreti i Anglisë dhe fotoja e saj “mbretërore” ishte kopërtina më e mirë shqiptare e kësaj stine.

Rilindja Kombëtare u frymëzua nga vlerat europiane të lirisë, pavarësisë, humanizmit, diturisë, emancipimit social-kulturor dhe u mor kthesa historike për kah Perëndimit. Shinat europiane janë sërish orientimi i shqiptarëve, por trenin tonë për atje e pengojnë “gurët në rrota”, që janë krimi, korrupsioni, antishteti i vetë shtetarëve e qytetarëve. Shqiptarët nuk besojnë më tek partitë, ndaj një Rilindje e Dytë do të ishte mbase i vetmi shpëtim.

AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

Akoma nuk jeni
regjistruar në Google?

Dotech
website 

Our Services:

- Business Cards
- Logos
- Banners
- Video Marketing

PËR ÇDO KONSULTIM
MUND TË VINI NË ZYRAT TONA



020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545

Adresa e zyrave:
30 Avenons Road
London E13 8HT

